

IZHA

UDHËZUES PËR SHKOLLAT QENDRA KOMUNITARE

Tetor, 2014



Ky botim publikohet në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtës së fëmijëve për edukim dhe zhvillim tërësor” të organizatës Save the Children, të zbatuar në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Përgatitën:

Albana Markja	Specialist IZHA
Evis Mastori	Specialist IZHA
Irida Sina	Specialist IZHA



Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit për zhvillim politikash dhe praktikash arsimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy institucioneve si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

UDHËZUES PËR SHKOLLAT QENDËR KOMUNITARE, NJË SHKOLLË MIQËSORE PËR TË GJITHË

Përmbajtja

I. SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE, NJË SHKOLLË MIQËSORE PËR TË GJITHË (SHQK) ..	6
Hyrje	6
I.1 Çfarë është shkolla si qendër komunitare?	7
I.2 Veçoritë e shkollës si qendër komunitare.....	7
I.3 Pse ngrihen shkollat si qendra komunitare?	8
I.4 Parimet bazë që udhëheqin shkollës si qendër komunitare	8
I.5 Veprimtari të shkollës si qendër komunitare.....	9
I.6Aktorët që përfshihen në shndërrimin e shkollave si qendra komunitare.....	11
I.6 Vizioni për zhvillimin e plotë të shndërrimit të shkollave si qendra komunitare.....	12
I.7 Karakteristika të procesit të shndërrimit të shkollave në qendra komunitare.....	12
I.8 Masa të ndërhyrjes për ngritjen e SHQK	13
II. NGRITJA E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE.....	13
II.1 HAPAT E PARË TË VEPRIMIT – VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE BURIMEVE	13
II.1.1. Modele instrumentesh për vlerësimin e nevojave dhe burimeve	20
Pyetësor në përmbushje të interesave të nxënësve	27
Vlerësim i nevojave nga mësuesit	31
Pyetësor me prindërit.....	32
II.2. HARTIMI I PLANIT TË SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE	35
III.AKTORËT DHE PARTNERËT E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE	43
III.1 Komunikimi dhe bashkëpunimi mes aktorëve brenda shkollës.....	43
III.1.1. Organizmat e shkollës.....	44
III.1.2. Përfshirja e prindërve.....	47
III.1.3. Komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetin.....	63
IV. TË SHKOSH NË SHKOLLË ME DËSHIRË ËSHTË NJË HAP I RËNDËSISHËM PËR JETËN E ÇDO NXËNËS	67
IV.1. Bashkëpunimi komunitar.....	69

Tabela 1: Organizimi i aktiviteteve nga shkolla dhe kërkesa ndaj komunitetit.....	71
Tabela 2: Planifikimi i aktiviteteve nga shkolla dhe komunitetit	71
IV.2. Organizimi i takimeve me prindër dhe komunitetin në ambientet e shkollës	72
SHTOJCË	75
I. Standardet e shkollës si qendër komunitare	75
I.1 Ç’janë standardet e shkollës si qendër komunitare	76
I.2 Pse nevojiten standardet e shkollës si qendër komunitare.....	76
I.3 Fushat e standardeve	77
I.4 Standardet e shkollës si qendër komunitare	77
FUSHA : SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR PËR ÇDO NXËNËS.....	77
FUSHA: SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDETËSORE TË NXËNËSVE	79
FUSHA : ANGAZHIM DHE ZHVILLIM I KOMUNITETIT.....	80
FUSHA: VENDIMMARRJA E PËRBASHKËT	83
FUSHA : GJITHËPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT	85
II. Udhëzimi i MAS për DAR/ZA dhe shkollat.....	87
BIBLIOGRAFIA	88

I. SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE, NJË SHKOLLË MIQËSORE PËR TË GJITHË (SHQK)

Hyrje

Shkolla qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë është një qasje (lëvizje promovuese dhe zhvilluese) për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.

Legjislacioni ynë për arsimin, ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, projektstrategjia e arsimit parauniversitar 2013-2020, si dhe dokumente të tjerë mbështesin funksionimin e një shkolle të hapur për vendimmarrje të përbashkët me familjen dhe komunitetin.

Koncepti i shkollës qendër komunitare, mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh të gjithë aspektet e reformës në arsim me vendosjen e fëmijës në qendër të vëmendjes në të gjitha veprimtaritë që organizohen dhe zbatohen në shkollë.

Për më shumë se dy dekada, në Shqipëri janë zhvilluar një numër iniciativash të cilat kanë përgatitur terrenin drejt krijimit të një kulture, filozofie, praktike dhe politike në mbështetje të shkollës miqësore për fëmijët e cila është gjithëpërfshirëse dhe e hapur për komunitetin.

Qasja e shkollës qendër komunitare është një dimension i rëndësishëm i reformimit të arsimit dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Ajo krijon mundësinë e vlerësimit të punës së shkollës në lidhje me bashkëpunimin shkollë-familje-komunitet dhe mbi këtë bazë, hartimin e strategjive që mbështesin ngritjen e një modeli të shkollës komunitare, përmes bashkëpunimit me të gjithë aktorët.

Përfitimet që ofrojnë shkollat komunitare janë të shumta dhe të shumëfishta. Ato sigurojnë, gjithëpërfshirje pa dallime gjinore e të natyrave të tjera, arritje më të mira të fëmijëve dhe të rinjve, garanci për një shëndet më të fortë, pjesëmarrje aktive në vendimmarrje të nxënësve, përfshirje dhe kontribut të gjerë të familjes, hapje ndaj komunitetit dhe strukturave vendore dhe mbrojtje për fëmijët dhe të rinjtë.

I.1 Çfarë është shkolla si qendër komunitare?

Shkolla qendër komunitare (SHQK) është një nismë e përbashkët që dallon për tërësinë e marrëdhënieve që lidhin shkollën, familjen dhe komunitetin. Ajo dallon për fokusin e saj në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe të rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbështetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus sigurinë dhe shëndetin si dhe shërbimet komunitare.

SHQK është një bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës, i fokusuar në:

- mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve,
- përmirësimin e arritjeve të tyre,
- mbështetjen e familjeve dhe,
- zhvillimin e komuniteteve.

SHQK synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre. Sistemi arsimor Shqiptar ka nevojë për shkollat komunitare, sepse vëzhgimet e kryera dhe përvoja ka treguar që fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses në studimet dhe veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë orarit mësimor. SHQK mbështetet në moton e të punuarit së bashku për një qëllim të përbashkët.

I.2 Veçoritë e shkollës si qendër komunitare

- SHQK konsiderohen ato institucione arsimore, të cilat i shërbejnë jo vetëm komunitetit shkollor (nxënës dhe mësues) por janë të hapura dhe në shërbim të gjithë anëtarëve të komunitetit.
- SHQK janë institucione të cilat ngrenë dhe zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit;
- SHQK ofrojnë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor, për nxënësit, familjet dhe komunitetin;
- SHQK pranojnë prindërit si bashkëedukatorë dhe angazhojnë ata në vendimmarrje të përbashkëta;
- SHQK sigurojnë kohezionin social;
- SHQK ngrihen mbi pikat e forta të komunitetit.

I.3 Pse ngrihen shkollat si qendra komunitare?

Shkolla duket se është transformuar në një institucion të mbyllur dhe të fokusuar vetëm në një funksion, atë të mësimdhënies dhe nxënies. Sot shumëkush e sheh atë si ishull të izoluar nga komuniteti. Shndërrimi i shkollave në qendra komunitare bën që ato të funksionojnë dhe të perceptohen si institucioni ku ndërveprohet, bashkëpunohet dhe krijohet.

Shkollat, familjet dhe komuniteti sot përballen me një sfidë të përbashkët: edukim cilësor për fëmijët e të rinjtë si dhe mundësi për t'iu përgjigjur nevojave të tyre përtej përgatitjes akademike. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Partneriteti me aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të projekteve me tematika të përbashkëta duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre dhe aftësuar nxënësit për të kontribuar për komunitetet e tyre.

Studimet dhe përvojat e suksesshme kanë treguar se kur shkollat punojnë në partneritet me aktorët e tjerë krijohen mundësitë për të tejkaluar barrierat e të nxënies duke çuar drejt suksesit. Në këtë kuptim SHQK nxisin për të synuar cilësi më të lartë.

Shkollat, familja dhe komuniteti punojnë së bashku:

- për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet
- për të pasuruar dhe nxitur përmes veprimtarive formale dhe jo formale
- për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin.

I.4 Parimet bazë që udhëheqin shkollën si qendër komunitare

- Sigurimi i një arsimit cilësor për çdo nxënës.
- Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve.
- Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit.
- Vendimmarrja e përbashkët.
- Respektimi i diversitetit.
- Përdorimi i burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

I.5 Veprimtari të shkollës si qendër komunitare

1. *Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve* – Shkolla si qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor.

Ka disa rrugë për të mbështetur zhvillimin akademik të nxënësve:

- Veprimtari për përforsim të të nxënit. Këto veprimtari bëhen për të zotëruar më mirë aftësitë që nxënësi po mëson në klasën e tij siç janë konsultimet lidhur me lëndët.
- Veprimtari për pasurimin e zhvillimit akademik. Këto kurse/klube ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar kurrikulare apo dhe fushave të tjera kurrikulare.

Shkolla ndërton kurse akademike (si kurset e shkencës, kurse plotësuese për nxënësit me vështirësi, etj), të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësit në orën e mësimin.

Shkolla ngre klube në mbështetje të thellimit dhe plotësimit të njohurive të tij në fusha të ndryshme apo të zhvillimit të të menduarit kritik (si klubet e debatit, klubet e leximit, klubet fjalës poetike etj).

2. *Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv* – Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.

Veprimtari që nxisin këtë aspekt të zhvillimit të nxënësve janë:

- Veprimtaritë sportive si volejball, basketboll, futboll, aerobi, etj
- Veprimtari kulturore si teatër, muzikë, kërcim, dramë, recitim, stilim, pikturë, etj

3. *Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes* – Shkolla si qendër komunitare i konsideron prindërit si partnerë dhe burim të rëndësishëm. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve.

Këto mund të jenë veprimtari që:

- ndihmojnë prindërit të ndjekin përparimin e fëmijës. Shkolla është tërësisht transparente para prindërve. Të tilla veprimtari janë, fletët informuese për prindërit, ditari i nxënësit, takimet periodike me mësuesit, etj
- ndihmojnë prindërit të mbështesin fëmijët e tyre dhe shkollën si institucion, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në shkollë. Të tilla veprimtari janë përfshirja në vendimmarrje përmes marrjes pjesë në organizma të shkollës (bordi i shkollës, këshilli i prindërve, etj), pjesëmarrjes në planifikimin e veprimtarive në shkollë (plani afatmesëm dhe vjetor i shkollës, projekte të shkollës, etj), pjesëmarrja në programe për të nxënin e nxënësve apo të rriturve (kurse kompjuteri, kurse për zhvillimin e aftësive të thjeshta profesionale, programe për ndihmën që mund të japin prindërit për nxënësit që kanë vështirësi, etj).
- plotësojnë nevojat e prindërve. Këtu përfshihen veprimtari ku prindërit shfrytëzojnë burimet që ofron shkolla (biblioteka, kompjuterët dhe interneti, mjediset dhe pajisjet sportive, etj) si dhe veprimtari ku prindërve shkolla i ofron ekspertizën e saj për të plotësuar një nevojë në një fushë të caktuar (kurse kompjuteri, gjuhë të huaj etj)


4. *Veprimtari për angazhimin e komunitetit* – Shkolla si qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

Shkolla përdor rrugë të ndryshme për të bashkëpunuar me komunitetin. Këto mund të jenë veprimtari:

- për të sjellë shërbimet dhe programet e komunitetit në shkollë. Në këtë rast shkolla vlerëson dhe shfrytëzon asetet e komunitetit si organizata dhe institucione, qendra të shëndetit fizik e mendor, institucione të arit dhe kulturës, biznese, etj.

- që fokusohen në projekte të përbashkëta që ndihmojnë shkollën dhe shërbimin komunitar.
- për të plotësuar nevojat e komunitetit. Këtu përfshihen veprimtari ku si prindërit, pjesëtarë të tjerë të komunitetit shfrytëzojnë burimet që ofron shkolla.

1.6 Aktorët që përfshihen në shndërrimin e shkollave si qendra komunitare



I.6 Vizioni për zhvillimin e plotë të shndërrimit të shkollave si qendra komunitare



I.7 Karakteristika të procesit të shndërrimit të shkollave në qendra komunitare

- Dy shkolla si qendra komunitare nuk mund të jenë identike. Secila prej shkollave krijon profilin e saj në bazë të nevojave të identifikuara dhe burimeve të vlefshme në shkollë apo komunitet.
- Procesi i shndërrimit të shkollës në qendër komunitare është zhvillues. Aktorët që bashkëpunojnë zbulojnë gradualisht mundësitë që disponohen dhe rrisin përfitimet për nxënësit, familjet dhe komunitetin.
- Në shkollën si qendër komunitare mundësohet përfshirja e vazhdueshme dhe e përhershme e aktorëve. Nxitja e reflektimeve të vazhdueshme nga ata, do të ndihmojë në rritjen dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të shkollës.

I.8 Masa të ndërhyrjes për ngritjen e SHQK

- Ndërgjegjësim i gjithë aktorëve mbi qasjen e shkollës si qendër komunitare përmes bisedave, tryezave, debateve të hapura, botimeve, etj.
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të larmishme.
- Vënia në dispozicion të shkollave e materialeve të domosdoshme për të mundësuar veprimtari të ndryshme të tematikave passhkollore.
- Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të shkollave, mësuesve, prindërve dhe përfaqësuesve në komunitet për bashkëpunim të efektshëm në veprimtarinë e shkollë.
- Fuqizimi i strukturave të shkollës, si bordi i shkollës, qeveria e nxënësve, këshillat e mësuesve etj, ku kanë rol aktiv prindërit dhe komuniteti.
- Hartimi dhe zbatimi i programe që mbështesin shkollat në eliminimin e fenomeneve si braktisja shkollore, dhuna në shkolla, zgjidhja e konflikteve, të drejtat e njeriut etj.
- Shkëmbimi i përvojave pozitive me institucione shkollore përtej vendit tonë.

II. NGRITJA E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

II.1 HAPAT E PARË TË VEPRIMIT – VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE BURIMEVE

Në procesin e shndërrimit të saj në qendër komunitare, çdo shkollë synon të shkojë drejt përmbushjes së standardeve të SHQK. Përcaktimi i standardeve dhe përmbushja e tyre nga shkollat nuk presupozon “standardizim” të shkollave. Në rrugën për të përmbushur këto standarde, çdo shkollë ndjek itinerarin e saj, bazuar në kushtet dhe mundësitë konkrete të saj dhe të komunitetit që e rrethon. Në këtë mënyrë, secila prej shkollave krijon profilin e saj në bazë të nevojave të identifikuara dhe burimeve të vlefshme në shkollë apo komunitet.

Shkollat komunitare janë efiçente kur vendimet që ato marrin në lidhje me programet dhe shërbimet mbështeten në të dhëna. Vlerësimet strategjike, të besueshme dhe të vlefshme të nevojave dhe burimeve janë komponentë të rëndësishëm për planifikimin dhe përmirësimin e

veprimtarisë së shkollës si qendër komunitare. Vlerësimi i nevojave dhe burimeve është hapi i parë në procesin e ngritjes së shkollës si qendër komunitare.

Përmes përfshirjes në këtë proces të të gjithë aktorëve: nxënësve, mësuesve, organizmave dhe strukturave të shkollës, komunitetit dhe familjes, disa prej të cilëve do të jenë partnerë afatgjatë, shkolla përfiton asistencë në mbledhjen e të dhënave. Në këtë mënyrë shkolla u siguron aktorëve akses në këto të dhëna si dhe u vjen në ndihmë për interpretimin dhe përdorimin e tyre.

Përmes vlerësimit të nevojave dhe burimeve dhe analizës së të dhënave të përfutur nga ky vlerësim, sigurohen:

- Informacion në lidhje me kushtet që do të ndihmojnë për identifikimin dhe evidentimin e asaj që është “e veçanta” në komunitetin e shkollës. Në këtë mënyrë, shkolla mund të adresojë nevojat, problemet dhe mundësitë e saj, jo duke transferuar apo importuar problemet e shkollave të tjera apo komuniteteve të tyre.
- Të dhëna që orientojnë më pas të gjithë procesin e planifikimit të veprimtarive të shkollës si qendër komunitare, si dhe që përcaktojnë llojin e veprimtarive dhe të shërbimeve që shkolla mund të ofrojë. Këto të dhëna shërbejnë si një “baseline” që shkolla mund ta përdorë për qëllime të shumta. Në këtë mënyrë çdo vlerësim i ri që mund të bëhet më tej si dhe të dhënat që rezultojnë prej tij mundësojnë krahasimin me “baseline-in” që shkolla do të vendosë fillimisht. Këto të dhëna i shërbejnë shkollës të përcaktojë progresin për plotësimin e nevojave dhe zgjidhjen e problemeve.
- Informacion për grupet që kërkojnë vëmendje “të veçantë”, fokus grupet.
- Informacion për pengesat që mund të ndikojnë në këtë proces të zhvillimit të shkollës.

Për të menaxhuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, me synim shmangien e mbingarkesës apo informacioneve të panevojshme, sugjerohet hartimi i një strategjie të strukturuar në të cilën përcaktohet:

- cilat të dhëna kanë më shumë rëndësi;
- cilat të dhëna duhet t’i mbledhë shkolla vetë;
- dhe si duhet t’i përdorë ato.

Ky vlerësim mund të kryhet një herë në vit ose një herë në dy vjet, si bazë për të parë ecurinë dhe përcaktuar nevojat.

Të dhënat që ndihmojnë në marrjen e vendimeve për programet dhe shërbimet që mund të planifikojë dhe zhvillojë një shkollë qendër komunitare, sigurohen përmes:

- *Vlerësimi të nevojave*
- *Vlerësimi të burimeve*

Vlerësimi i nevojave u jep përgjigje pyetjeve të tilla, si:

- Nga cilat programe dhe shërbime përfitojnë më tepër nxënësit?
- Cilat shkaqe dhe kushte mund të ndikojnë në llojin e programeve dhe shërbimeve që mund të ofrohen?
- Cilat programe dhe shërbime do ta bënin më të lehtë që familjet të mbështesin fëmijët e tyre?
- Cilat programe dhe shërbime do ta bënin më të lehtë që partnerë të komunitetit të mbështesin shkollën, apo që shkolla t'i shërbejë komunitetit?
- Me cilët duhet bashkëpunuar për vlerësimin e nevojave? Nxënësit, prindërit, mësuesit, anëtarët e komunitetit?
- Si mund të mblidhet ky informacion?

Vlerësimi i nevojave aftëson shkollën për identifikimin dhe prioritizimin e nevojave të individëve/grupeve që janë ose do të bëhen pjesë e programeve dhe shërbimeve që shkolla do të ofrojë dhe marrë. Duke e dhënë “zë” njerëzve që marrin pjesë në këtë proces, vlerësimi i nevojave inkurajon pronësinë e programeve dhe u jep atyre role në zhvillimin e shkollës si qendër komunitare. Ky vlerësim siguron rrugë për të shkuar drejt anëtarëve të komunitetit përtej mureve të shkollës, në mënyrë që t'u bëhet e ditur ç'bëhet në shkollë, si ato mund të përfitojnë, dhe si mund të mbështesin transformimin e saj.

Vlerësimi i burimeve u jep përgjigje pyetjeve të tilla, si:

- Cilat burime, materiale dhe njerëzore, janë aktualisht të vlefshme në shkollë dhe në komunitet?
- Si përdoren këto burime?
- Çfarë i ofron shkolla atyre që do të mundësojnë që këto burime të jenë më efektive?

Vlerësimi i burimeve ndihmon shkollën të kuptojë atë që është e vlefshme (apo e pavlefshme) në komunitetin e saj me qëllim që të adresojë kushtet dhe nevojat kritike. Informacioni i mbledhur mund t'i shërbejë shkollës për bashkëbisedimet me partnerë potencialë të komunitetit si dhe mbështet përpjekjet e shkollës për zhvillimin e burimeve që mungojnë në komunitet. Ky proces kalon përmes disa hapave:

Hapi 1: Krijimi i një ekipi për vlerësimin e nevojave dhe burimeve

Planifikimi i strategjisë së vlerësimit të nevojave dhe burimeve dhe realizimi i këtij procesi, kërkon angazhimin e aktorëve të cilët kanë interes për shkollën dhe komunitetin dhe mund të kontribuojnë për zhvillimin e partneritetit shkollë-familje-komunitet.

Pranë çdo shkolle funksionon një ekip koordinues i përbërë nga drejtori (ose nëndrejtori) i shkollës i cili është dhe drejtues i ekipit, anëtarë të bordit të prindërve, nxënës përfaqësues të qeverisës së nxënësve, mësues të shkollës, përfaqësues të pushtetit vendor si dhe përfaqësues të partnerëve të tjerë socialë. Ky ekip angazhon përfaqësues të tij ose ngre një ekip të posaçëm, i cili angazhohet në procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve.

Krijimi i një ekipi për vlerësimin e nevojave dhe burimeve kërkon që shkolla të jetë gjithëpërfshirëse. Në një proces të tillë mund të përfshihen:

- Nxënës
- Prindër
- Staf i shkollës
- Përfaqësues të komunitetit lokal
- Drejtues të agjensive publike
- Përfaqësues të organizata të ndryshme
- Përfaqësues të mediave lokale
- Përfaqësues të universiteteve
- Përfaqësues të biznesit
- Etj.

Një nga çelësat e suksesit është aftësia për të rekrutuar dhe mbajtur për një kohë të gjatë aktorët, përfshirë aftësinë për të mobilizuar dhe shpërndarë burimet që ato ofrojnë. Vlerësimi dhe përfitimet që lidhen me të duhen konsideruar si një proces dykahësh: Për të krijuar profilin e një shkolle miqësore dhe të hapur për të gjithë, shkollat kanë nevojë për të dhëna që lidhen me atë vetë, me familjen, me shërbime, programe të institucioneve, organizatave, etj., pra me të dhëna që mundësohen nga komuniteti.

Nga ana tjetër, të dhënat që sigurohen nga ky vlerësim mund t'i shërbejnë komunitetit për programe dhe shërbime të ndryshme që zhvillon. Për shembull, shërbimet shëndetësore dhe sociale kanë nevojë për të dhëna në lidhje me progresin dhe nevojat e shkollës. Pra, përfitimi që rezulton në një rast të tillë është reciprok.

Hapi 2: Zhvillimi i një plani vlerësimi dhe realizimi i tij

Hapi i dytë në procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve është hartimi i një plani pune në të cilin detajohet mënyra si do të kryhet vlerësimi.

Plani duhet të përfshijë afate, detyra, përgjegjësitë e anëtarëve dhe të parashikojë produkte.

Në këtë fazë është mjaft e rëndësishme që ekipi vlerësues të koordinojë punën për angazhimin e të gjithë aktorëve.

Në një proces të tillë ndodh që disa anëtarë të veçohen apo të neglizhohen dhe në këtë mënyrë të marginalizohen. Shkolla duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët të kenë një rol dhe të zhvillojë një mjedis që inkurajon besim dhe mundësi për kontributin e të gjithë anëtarëve. Takimet duhen planifikuar dhe menaxhuar në mënyrë të tillë që të dëgjohen të gjithë zërat.

Çështje të etikës së mbledhjes së të dhënave

Ruani konfidencialitetin!

Shkolla duhet të bëjë kujdes në përdorimin e të dhënave. Është e rëndësishme të mos përdoren emrat e nxënësve, prindërve, personave të tjerë që janë objekt i vlerësimit, adresat e tyre apo informacione të tjerë.

Adresoni pengesat apo mundësoni incentiva!

Shkolla mund të hasë në pengesa që e bëjnë të vështirë mbledhjen e të dhënave. Mendoni për sfidat që mund të hasni në këtë proces. Në disa raste mund të përdoren incentiva për plotësimin e instrumenteve të vlerësimit nga aktorë të ndryshëm, si p.sh., nxënësve që angazhohen në këtë proces mund t’u njihet si kontribut me kredite shtesë.

Strategjitë për mbledhjen e të dhënave mund të përfshijnë:

STRATEGJIA	PËRSHKRIMI	AVANTAZHET
Fokus grupet	Fokus grupet janë grupe personash me interesa të përbashkëta, të moderuar nga një person (moderator), i cili përdor grupin dhe ndërveprimin midis tyre për të mbledhur informacion për çështje specifike nga këndvështrime dhe perspektiva të ndryshme. Grupet zakonisht përbëhen nga 7-9 pjesëmarrës.	<ul style="list-style-type: none"> - Janë lehtësisht të menaxhueshëm. - Mund të jetë me efëçente se metodat e tjera të vlerësimit. - Ndërton identitetin e komunitetit përmes diskutimeve mbi çështjet e komunitetit. - Zhvillon konsensusin përmes vendosjes së prioriteteve.

<p>Intervistat</p>	<p>Biseda me strukturë të lirë gjatë së cilave diskutohen çështje apo tema të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mundësojnë përgjigje të detajuara për çështjet. - Kërkojnë minimumin e burimeve. - Janë fleksibël. - Fokusohen në çështje specifike të vlerësimit të nevojave. - Sigurojnë shkallë të lartë përgjigjesh. - Vendosin rrugë komunikimi me agjensitë e ndryshme të shërbimeve.
<p>Pyetësorët/Anketat</p>	<p>Pyetësorët janë instrumente që konsistojnë në një radhë pyetjesh që më të shumtën e rasteve kërkojnë përgjigje standarde.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Janë praktikë. - Mund të mblidhet informacion për një numër të madh individësh brenda një periudhe të shkurtër kohe. - Janë lehtësisht të përpunueshëm. - Sigurojnë autonomi për ato që japin përgjigje.

II.1.1. Modele instrumentesh për vlerësimin e nevojave dhe burimeve

VLERËSIMI I NEVOJAVE TË NXËNËSVE TË KLASËS 6 – 9

(Shkolla) kërkon nga ju plotësimin e këtij pyetësori me qëllim identifikimin e rrugëve që mbështesin suksesin tuaj në shkollë dhe në jetë. Ju lutemi, përgjigjuni secilës pyetje.

Faleminderit!

Informacion personal:

▪ Jeni ___Djalë ___Vajzë?

▪ Sa vjeç jeni?

___9 ___10 ___11 ___12 ___13 ___14 ___Më i madh se 14

▪ Në ç'klasë jeni?

___4 ___5 ___6 ___7 ___8

▪ Keni vëllezër ose motra?

Vëllezër ___(sa) Moshë e vëllait/vëllezërve _____

Motra _____(sa) Moshë e motrës/motrave _____

Informacion për ju dhe shkollën tuaj:

▪ Ju lutem, shënoni (x) nëse jeni dakord ose jo me pohimet e mëposhtme:

Dakord Nuk jam dakord

Nxënësit në shkollën time shkojnë mirë me njëri-tjetrin.

Mësuesit na dëgjojnë.	_____	_____
Unë mund t'i kërkoj ndihmë mësuesit kur nuk kuptoj detyrat.	_____	_____
Unë ndjehem i sigurt në shkollë.	_____	_____
Më pëlqen të vij në shkollë.	_____	_____
Të rriturit në shkollë i trajtojnë nxënësit me respekt.	_____	_____
Nxënësit në shkollë i trajtojnë të rriturit me respekt.	_____	_____

- Sa kohë shpenzoni duke bërë detyrat e shtëpisë pas orarit të shkollës:

___ <1/2 orë, ___ 1/2-1 orë, ___ 1-2 orë, ___ s'ka kohë

- Kush ju ndihmon me detyrat e shtëpisë kur keni nevojë (mund të përzgjidhni më shumë se një tregues):

___ Prindërit

___ Gjyshërit ose kujdestarët

___ Të afërm të tjerë (vëllezër/ motra, xhaxha/dajë)

___ Shokë/shoqe

___ Mësues

___ Programe passhkollorë

___ Të tjera

- Si ka qenë frekuentimi i shkollës nga ju muajin e shkuar?

___ Nuk kam munguar asnjë ditë në shkollë

___ Kam munguar një ditë

___ Kam munguar 2 ditë

___ Kam munguar 3-4 ditë

___ Kam munguar më shumë se 4 ditë

- Përse mungoni zakonisht në shkollë?

___ Jam i sëmurë

___ Prindërit kanë nevojë për mua

___Nuk kam mundësi të shkoj në shkollë

___Nuk dua të shkoj në shkollë

___Nuk e di

- Si ka qenë sjellja juaj në shkollë muajin e shkuar?

___Nuk kam shkaktuar kurrë shqetësime

___Kam shkaktuar shqetësime në klasë

___Unë gjithmonë kam shkaktuar shqetësime

- Jeni larguar (përgjashtuar) ndonjëherë nga shkolla?

___Jo ___Po Sa herë?_____

- Si jeni me rezultatet në mësimet?

___Notat e mia janë shumë të mira ___Notat e mia janë të mira ___Notat nuk i kam të mira

- Çfarë mendoni do t'ju ndihmonte në ecurinë tuaj në shkollë?

Kur jeni në shkollë....

Ju shajnë? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh

Ju rrahin/ Rrihni? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh

Ndjeheni i/e kënaqur? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh

Jeni i interesuar? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh

Kur nuk jeni në shkollë,

Luani sport ose lojra të tjera? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh

Merrni pjesë në veprimtaritë sportive

ose të tjera në shkollë? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh
 Merrni pjesë në klubet e shkollës? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh
 Merrni mësimë kërcimi, teatri, muzike? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh
 Shkoni në një qendër interneti? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh
 Përdorni kompjuterin në shtëpi? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh
 Luani me video games? ___Po ___Jo ___Ndonjëherë ___Shpesh

- Në 6 muajt e fundit keni përdorur:

___Cigare ___Birrë ___Alkool ___Droga të tjera ___Asnjë prej tyre

- Çfarë veprimtarish do t'ju pëlqente të zhvilloheshin në shkollën tuaj gjatë ose pas mësimimit?

___Ndhimë në shkollë ___Këshillim ___Sporte

___Art figurativ ___Kërcim ___Muzikë ___Lojëra ___Teatër

___Kinema ___Klasa kompjuteri

VLERËSIMI I NEVOJAVE TË NXËNËSVE (SHKOLLA E MESME)

	<i>Nuk dakord</i>	<i>jam pavendosur</i>	<i>Jam i/e</i>	<i>Jam dakord</i>
1. Shkolla zhvillon aftësitë që më përgatisin për jetën.				
2. Jam i/e përgatitur të diplomohem në kohë.				
3. Mësuesit krijojnë mundësi që ne të japim më të mirën.				

4. Kur kam nevojë për ndihmë për detyrat ose diçka tjetër, mësuesit më japin ndihmën e nevojshme.			
5. Prindërit kanë besim te unë.			
6. Mësuesit njohin dhe kuptojnë kulturën time.			
7. Mësuesit më trajtojnë me respekt.			

8. Pas shkollës së mesme, unë dua.....

të kem një punë të mirëpaguar të shkoj në universitet nuk jam e sigurtë

9. Shkolla e mesme po më përgatit për arritjen e këtij qëllimi.

Po Jo Ndonjëherë

10. Në klasën time, unë kam mundësi të.....

11. Pas mësimit, unë marr pjesë në veprimtaritë e mëposhtme:

Asnjë

Punë

Ekipe sportive

Punë shtëpie

Programe argëtuese

12. Në shkollën time, kam parë:

Nxënës që janë lidera

Prindër që ndihmojnë

Vajza që nuk trajtohen me kujdes

Nxënës që konfliktohen

Racizëm apo diskriminim

Nxënës që shahen midis tyre

	<i>Nuk jam dakord</i>	<i>Jam i/e pavendosur</i>	<i>Jam dakord</i>
13. Mësuesit i marrin parasysh mendimet dhe idetë tona.			
14. Qëkurse kam nisur shkollën e mesme, kam marrë pjesë në veprimtari të shërbimit komunitar.			
15. Unë shoh qartë si gjërat që po mësoj në shkollë do të më shërbejnë në të ardhmen.			
16. Klasa ku unë mësoj më inkurajon për punë sfiduese.			
17. Unë mund t'i zbatoj gjërat që po mësoj në situata të jetës së përditshme.			
18. Unë ndjehem i sigurtë në shkollë.			
19. Unë ndjehem i sigurtë në rrugën nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.			
20. Shkolla ime ka shumë libra dhe materiale për çdo nxënës.			
21. Shkolla ka kompjutera mjaftueshëm për të gjithë.			
22. Nëse kam një shqetësim serioz, mund të kërkoj ndihmë në shkollë.			
23. Nëse familja ka një problem serioz, unë di ku duhet të drejtohem në komunitet.			

24. Prindërit e mi kanë informacion për ecurinë timë në shkollë.			
25. Unë lexoj libra, revista apo materiale të tjera, përveç atyre që lexoj në shkollë.			

26. Kur kam mundësi, unë....

- Pi cigare
- Pi alkool
- Bëhem pjesë e veprimtarive kriminale
- Përdor drogë
- Marr pjesë në veprimtari të dhunshme

27. Unë kam përvoja të tilla, si:

- Largime nga shtëpia
- Diskriminim
- Jam arrestuar
- Jam mbajtur peng
- Jam kërcënuar
- Shahem me shokët/shoqet
- Ha shumë më tepër se ç' duhet

28. Kur kam një problem, kam gjithmonë dikë me të cilin ndaj.

- Po Jo Ndonjëherë

29. Pengesat më të mëdha për mua në shkollë janë:

- Prindërit nuk më ndihmojnë
- Miqtë e mi mendojnë që shkolla nuk është e rëndësishme
- Kam shumë probleme në shtëpi
- Mësuesit nuk interesohen për mua

- Unë duhet të punoj për të fituar para
- Mësimet janë të vështira
- Shkolla është e mërzitshme
- Jam shtatzënë
- Kam një fëmijë
- Shoku/shoqja/ ose partneri nuk pëlqen që unë të vij në shkollë
- Nuk më duhet shkolla për të ardhmen time.

PYETËSOR NË PËRMBUSHJE TË INTERESAVE TË NXËNËSVE

Shkolla juaj po punon për zhvillimin e programeve të reja për nxënësit, prindërit, dhe anëtarë të tjerë të komunitetit. Ne kemi nevojë për informacionin tuaj në mënyrë që të identifikojmë programet që kanë interes për ju.

Ju lutem, shënoni të gjitha veprimtaritë në të cilat ju do të dëshironit të merrnit pjesë, nëse janë të vlefshme pas shkolle apo në fundjavë.

Faleminderit për ndihmën tuaj!

SPORTE	FUNDJAVË	PAS SHKOLLE
Basketboll		
Boks		
Volejboll		
Karate		
Tenis		
Bejsboll		
Not		
Ping pong		

Të tjera _____

ZHVILLIM PERSONAL	FUNDJAVË	PAS SHKOLLE
Këshillim individual		
Këshillim në grup		
Çështje të prindërimit		
Çështje të divorceve		
Vetëvlerësim		
Çështje gjinore		
Menaxhim ankthi		
Çështje të abuzimit me fëmijët		
Zgjidhje konflikti		
Çështje që lidhen me alkoolizmin		
Program mentorimi		

Të tjera _____

VEPRIMTARI SHOQËRORE	FUNDJAVË	PAS SHKOLLE
Kërcim		
Kinema		
Muzeum		
Boëling		

Lojëra		
Koncert		
Teatër		

Mbështetje grupeve për: _____

Ëorkshope për: _____

Të tjera: _____

PËRGATITJE PËR PUNË	FUNDJAVË	PAS SHKOLLE
Shkrim i një përmbledhjeje ose CV-je		
Aftësi intervistuese		
Të nxënit për karrierën		
Të folur publik		
Kurse për mekanik		

- Për cilat profesione jeni të interesuar më shumë?

Të tjera _____

ARTE	FUNDJAVË	PAS SHKOLLE
Punë dore		
Vizatim		

Fotografi		
Drama		
Poezi		
Art grafik		
Instrument		
Kërcim		

- Çfarë instrumenti?

- Çfarë lloj kërcimi?

Të tjera _____

VEPRIMTARI AKADEMIKE	FUNDJAVË	PAS SHKOLLE
Ndihmë për detyrat e shtëpisë		
Kurs matematike		
Kurs i shkencës		
Debat		
Dizajn		
Kompjuter		
Art		

- Sa vjeç jeni? 9 10 11 12
- Çfarë veprimtarish të reja do t'ju pëlqente t'ju ofronte shkolla?

VLERËSIM I NEVOJAVE NGA MËSUESIT

Shkolla si qendër komunitare ndërton partneritetin dhe organizon burimet (programet dhe shërbimet) për të mbështetur zhvillimin e suksesshëm të nxënësit. Nxënësit përballen me sfida që ndikojnë zhvillimin e tyre. Komuniteti dhe familja duhet të punojnë së bashku për të adresuar zhvillimin e suksesshëm të të rinjve.

Mendoni për shkollën tuaj si qendër komunitare dhe merrni në konsideratë shkallën e mëposhtme të vlerësimit:

Shkalla e vlerësimit të nevojave									
Shkallë e ulët e nevojave			Shkallë mesatare e nevojave				Shkallë e lartë e nevojave		
Burime të përshtatshme për plotësimin e nevojave të nxënësve.			Burime të pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të nxënësve.				Nuk ka burime që do të plotësonin nevojat e nxënësve.		
<i>E ulët</i>			<i>Mesatare</i>				<i>E lartë</i>		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

Përdorni shkallën e mësipërme për të vlerësuar përgjigjen tuaj në lidhje me plotësimin e nevojave të nxënësve.

Fusha e zhvillimit Programi/Shërbimi	Vlerësimi sipas shkallës	Fusha e zhvillimit Programi/Shërbimi	Vlerësimi sipas shkallës
Zhvillim konjitiv		Zhvillim social	
Përforcim		Aftësi komunikuese	
Zgjerim i njohurive (përvojave mësimore)		Marrëdhënie me bashkëmoshatarët	
Zhvillim fizik		Punë në grup	
Shërbime shëndetësore		Aftësi drejtuese	
Programe për ushqyerjen			
Sporte			
Programe dhe veprimtari krijuese			

Zhvillim emocional			
Aftësi për jetën			
Ndërhyrje në raste krizash			
Këshillim dhe terapi			

Marrëdhënia e mësuesve me prindërit dhe të tjerët

1. Mesatarisht, sa herë kontaktoni me prindër apo kujdestarë për nxënësit e klasës tuaj?

___Çdo ditë ___Çdo javë ___Dy herë në javë ___Çdo muaj ___Dy herë në muaj

2. Si komunikoni më të shumtën e rasteve?

___me shkrim ___me telefon ___në shkollë ___në shtëpinë e tyre

3. Listoni tre prioritete në të cilat duhet të fokusohemi për të mbështetur suksesin e nxënësve?

4. Përveç rolit tuaj si mësues, si do t’ju pëlqente të përfshiheshit në mbështetje të zhvillimit të nxënësve tuaj?

___në ekipin planifikues _____në programet akademike
 ___në programet jo akademike _____në punën me komunitetin
 ___në programet për prindërit _____të tjera _____

Faleminderit që morët pjesë në plotësimin e këtij vlerësimi!

Ne do t’ju vëmë në dijeni të rezultateve të këtij vlerësimi pasi të jenë përpunuar.

PYETËSOR ME PRINDËRIT

Ju lutemi, përgjigjuni çështjeve të mëposhtme në lidhje me programet për fëmijën/ët tuaj.

1. A ndjek fëmija/fëmijët tuaj një program pas shkolle?

___PO ___JO

2. Sa ditë në javë e ndjek fëmija juaj programin pas shkolle?

1 2 3 4

3. Përse e keni regjistruar fëmijën tuaj në një program pas shkolle?

___për t'u argëtuar
___për t'i mbushur kohën
___për të qenë i sigurtë pas shkolle
___për të zhvilluar aftësi që i nevojiten
___për të krijuar miqësi
___për të patur ndihmë për detyrat e shtëpisë
___të tjera _____

4. Cilat kanë qenë përfitimet e pjesëmarrjes së fëmijës tuaj në programet pas shkolle?

___ Argëtohet
___Ka me se merret pas shkolle
___Është i sigurtë pas shkolle
___Zhvillon aftësi që i nevojiten
___Krijon miqësi
___Ka ndihmë për detyrat e shtëpisë
___të tjera _____

Shkollasynon t'u vijë në ndihmë fëmijëve të jenë të suksesshëm në shkollë.
Ndonjëherë fëmijët përballen me sfida që e bëjnë të vështirë suksesin.

Ju lutem, jepni mendimin tuaj për mënyrën si mund të ndihmohen nxënësit të kenë sukses:

5. Me cilat lloj sfidash (në këtë komunitet) përballen nxënësit që e bëjnë më të vështirë suksesin?

- Vështirësi në lexim
- Vështirësi në matematikë dhe shkenca
- Probleme të shëndetit fizik
- Probleme të shëndetit mendor
- Nevojë për modele pozitive rolesh
- Marrëdhënia më të mira me mësuesit
- të tjera _____

6. Cilat lloj programesh gjykoni se mund t'ju vijnë më shumë në ndihmë fëmijëve tuaj për të patur më shumë sukses në shkollë?

- Programe për përmirësimin e të lexuarit
- Programe në matematikë dhe shkenca
- Shërbime që mbështesin familjen
- Programe mentorimi
- Shërbime shëndeti dhe për ushqyerjen
- Programe për menaxhimin e sjelljes për nxënësit
- Programe që u vijnë në ndihmë fëmijëve për fëmijëte tyre
- Shërbime të shëndetit mendor
- Programe të aftësive për jetën
- Mundësi për prindërit dhe nxënësit që të punojnë së bashku
- Të tjera _____

7. Do të kishit dëshirë të diskutonit në një takim për nevojat e nxënësve?

PO JO

8. Do të dëshironit të punonit për programe dhe shërbime për fëmijët tuaj?

____PO

____JO

____JO

9. Si mund të kontaktojmë me ju?

Emri Juaj _____

Telefoni _____ Email _____

II.2. HARTIMI I PLANIT TË SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

Pas vlerësimit të kushteve dhe burimeve të shkollës për të qenë një qendër komunitare, shkolla ka identifikuar kushtet konkrete të institucionit, nxënësve, sfafit edukativ, familjeve dhe komunitetit, të cilat potencialisht përmbajnë edhe pengesat për zhvillimin e plotë të potencialit të nxënësve dhe suksesit të tyre në shkollë. Në fazën e parë të punës për hartimin e programit, bashkë me partnerët, janë identifikuar gjithashtu edhe burimet e vlefshme në komunitetin e shkollës. Tani është e nevojshme të hartohet një plan me të gjithë shërbimet që shkolla dhe partnerët mund të ofrojnë duke synuar përmirësimin e të nxënësve.

Parimet dhe strategjitë gjithëpërfshirëse për një planifikim të sukseshëm

Gjatë punës për konceptimin, hartimin dhe zbatimin e planit të shkollës si qendër komunitare është e rëndësishme të mbahen parasysh dhe përdoren strategjitë e përmendura më poshtë. Nëse ato konsiderohen dhe mbahen parasysh, shkolla, nxënësit, prindërit, familjet dhe komuniteti do të përfitojnë.

Parimet dhe strategjitë gjithëpërfshirëse për një planifikim të sukseshëm	
<i>Parimet</i>	<i>Përcaktimi</i>
Struktura	

<i>I orientuar nga rezultatet</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani hartohet për të arritur disa rezultate të caktuara në lidhje me grupin e synuar. Stafi i shkollës e di se nuk mjafton thjesht hartimi dhe ofrimi i programit dhe shërbimeve. Ata ndjehen përgjegjës për rezultatet e synuara
<i>Gjithëpërfshirës</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani adreson faktorët e rrezikut, anët e forta dhe aspiratat, dhe ndërton kompetenca. Plani i drejtohet grupeve të shumta si p.sh., familjeve, shkollave dhe komuniteteve . Plani zhvillon lidhje dhe rrjete komunikimi mes të gjithë grupeve (shkolla - shtëpi, familja - shkollë, etj). Plani përdor strategji të shumta për të përmbushur qëllimet.
<i>I mbështetur në dispozita dhe përvojë</i>	<ul style="list-style-type: none"> Hartuesit e planit konsultojnë të gjitha dispozitat ligjore të MAS për hartimin e tij. Grupi që harton programin dhe stafi i shkollës konsulton dhe përshtat modele programesh, planesh dhe përvojash tashmë të njohura si të suksesshme.
Zbatimi	
<i>Doza e mjaftueshme</i>	<ul style="list-style-type: none"> Shpeshtësia, intensiteti dhe kohëzgjatja e programit dhe veprimtarive të parashikuara në të duhet të jenë të mjaftueshme për të të arritur rezultatet e dëshiruara Sipas nevojës përfshihen veprimtari përforcuese që pasojnë planin
<i>Korrektësia e zbatimit</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani duhet të zbatohet sipas të gjitha veprimtarive të parashikuara që në fillim të hartimit të tij Stafi i shkollës di që nuk mund të bëhen ndryshime sepse përndryshe rrezikohen rezultatet e pritshme
<i>Stafi i trajnuar mirë</i>	<ul style="list-style-type: none"> Stafi i shkollës mbështet planin dhe siguron zbatimin korrekt të tij. Stafi i shkollës është i trajnuar, i vlerësuar dhe i mbështetur Stafi duhet të përfshihet në veprimtaritë për zhvillimin profesional të ndërmarra në nivel lokal dhe kombëtar.
<i>Menaxhimi dhe udhëheqja e shpërndarë</i>	<ul style="list-style-type: none"> Të gjithë pjesëmarrësit kanë një rol të qenësishëm në hartimin e planit, zbatimin dhe përmirësimin e tij. Ato duhen parë si partnerë e mbështetës dhe jo si klientë të varur.
I fokusuar dhe strategjik	

<i>I personalizuar për t'iu përgjigjur nevojave personale</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani i drejtohet nxënësve dhe aktorëve të tjerë në mënyrë që secili individ të marrë trajtim te veçantë dhe të ketë mundësi të caktuara sipas nevojave të tij.
<i>Koha dhe vendi i duhur</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani fillon së funksionuari që në fillim të vitit shkollor, është i ndjeshëm ndaj nevojave specifike të secilit dhe realizohet në kohën dhe vendin e përcaktuar.
Thekson vlerat	
<i>Vlerat kulturore</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani përshtatet ndaj normave dhe vlerave kulturore të çdo aktori që përfshihet në të. Plani duhet të marrë parasysh karakteristikat e veçanta të komunitetit në lokalitetin përreth.
<i>Mbështetës për familjet</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani hartohet për të mbështetur dhe forcuar familjet si dhe për të njohur nevojat dhe aspiratat e tyre. Veprimtaritë e parashikuara në plan funksionojnë në bashkëpunim të ngushtë me prindërit, stafi i shkollës bën përpjekje të posatshme për rekrutimin, përfshirjen dhe angazhimin e prindërve si pjesëmarrës dhe partnerë.
<i>I orientuar drejt fuqizimit</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani ndihmon në zhvillimin e kapaciteteve të individëve, grupeve dhe familjeve për veten dhe njëri tjetrin si dhe për të përfituar nga shërbimet, mbështetja, burimet që ata duan dhe kanë nevojë.
Marrëdhëniet dhe ndikimi	
<i>Marrëdhëniet pozitive</i>	<ul style="list-style-type: none"> Plani nxit marrëdhënie të forta ndërpersonale mes pjesëmarrësve në të, stafit mësimor, etj. Plani nxit lidhje me persona dhe institucione të tjerë në mënyrë që të promovojë vlera dhe norma pozitive
<i>Domethënës dhe argëtues</i>	<ul style="list-style-type: none"> Është e nevojshme që plani të jetë argëtues (i parë nga sytë e pjesëmarrësve). Plani përfshin gjithashtu aktivitetet që janë të vlefshme për pjesëmarrësit si brenda ashtu dhe jashtë planit.

Pasi plani hartohet, është e rëndësishme të bëhet vlerësimi i të gjithë elementëve përbërës të tij për të parë nëse ai është gjithëpërfshirës dhe përmbush qëllimet e vëna. Tabela e mëposhtme

paraqet një listëkontrolli të disa prej elementëve dhe parimeve kryesore që duhet të përmbajë plani juaj.

Listë kontrolli e parimeve dhe/ose strategjive gjithëpërfshirëse që përmban plani që keni hartuar

- Plan i është hartuar që të përmbushë rezultatet e parashikuara në të.
- Plan i përdor strategji të ndryshme për të përmbushur qëllimet e vëna.
- Në plan është e dukshme lidhja mes shërbimeve të ofruara dhe rezultateve të parashikuara.
- Plan i parashikon dhe nxit vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij.
- Plan i zbatohet ashtu sic ishte parashikuar në fillim.
- Staf i mësimor është i mirëtrajnuar për hartimin e planit.
- Pjesëmarrësit kanë mundësi të thonë mendimin e tyre për mënyrën se si programi është i strukturuar dhe zbatohet.
- Plan i është hartuar për të plotësuar nevojat individuale të të gjithë aktorëve në të.
- Plan i zbatohet duke respektuar veçoritë kulturore të të gjithë aktorëve.
- Plan i është mbështetës për familjet e prindërit dhe i vë ato në qendër.
- Plan i krijon mundësi për lidhje dhe marrëdhënie pozitive mes të gjithë aktorëve pjesë të veprimtarive.
- Veprimtaritë e parashikuara në plan janë domethënëse dhe të pëlqyeshme për aktorët e përfshirë në të.

Formati i planit të veprimtarive të shkollës si qendër komunitare

Pa dyshim që secila shkollë, pasi ka kryer një vlerësim të nevojave që ka dhe burimeve të vlefshme për t'u zhvilluar si qendër komunitare, mund të zhvillojë planin e vet të veprimtarive i cili nuk mund të ngjajë me atë të një shkolle tjetër për arsye të specifikave që kanë aktorët në komunitetin e saj si dhe burimeve që disponohen. Megjithatë, ofrimi i një formati plani për zhvillimin e shkollës si qendër komunitare do të ishte orientues dhe i vlefshëm. Një format plani ju ndihmon për të identifikuar elementët kryesor përbërës të një plani, si këto elementë përbërës lidhen me njëri tjetrin dhe plotësohen bashkërisht, si dhe si aktorët e përfshirë në plan përfitojnë nga veprimtaritë e parashikuara në të.

Formati i një plani është paraqitja grafike e përmbajtjes, strukturës dhe rrjedhës së strategjisë që shkolla ka për tu zhvilluar drejt përshtatjes dhe zhvillimit si qendër komunitare. Në këtë format përfshihen edhe supozimet, synimet, aktivitetet, rezultatet e dëshiruara afatshkurtër dhe afatgjatë.

Kushtet dhe burimet

Në fillim duhen identifikuar kushtet akademike dhe shoqërore që plani do iu adresohet. Është e rëndësishme të mbahen parasysh avantazhet dhe dobësitë e nxënësve dhe familjeve të tyre, të shkollës dhe komunitetit. Vlerësimi i kushteve dhe burimeve ndihmon, shkollën t'i përgjigjet pyetjeve:

- Kujt duam t'i shërbejmë?
- Pse komuniteti rreth nesh ka nevojë për programe dhe shërbime?
- A ka në komunitetin tuaj një grup të veçantë që ka nevojë për shërbime ndryshe nga të tjerët?
- Si dhe sa do të ndryshojnë aktorët e përfshirë si rezultat i programeve dhe shërbimeve të ofruara?

Justifikimi i planit

Pas këtij hapi identifikoni bëhet një përshkrim i arsyeve që justifikojnë veprimtaritë e programit. Tek ky element i planit shprehet qartë se pse shkolla mendon që veprimtaritë e planifikuara do ta çojnë drejt rezultateve të dëshiruara duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve:

- Sipas kërkimeve që keni bërë, cili lloj plani i përgjigjet më mirë nevojave të komunitetit tuaj apo problemeve të identifikuar?
- Ai i përgjigjet logjikisht plani juaj nevojave të të gjithë aktorëve në komunitet?
- A është ndërtuar plani referuar praktikave më të mira që ju keni krijuar apo dini që janë efektive?

Burimet e planit

Në këtë element të planit identifikohen të gjitha burimet e nevojshme që nevojiten për zbatimin e tij. Burimet në plan parashikohen në shkallë të gjerë, duke përfshirë elementë si: buxheti, stafi, vullnetarët, pajisjet, shërbimet e kontraktuara dhe mbështetëse. Në këtë rubrikë mund të

përmendet edhe ndonjë gjë që mund ta kufizojë apo mbështesë planin, siç janë ligjet, urdhrat, udhëzimet dhe rregulloret e MAS.

Veprimtaritë e planit

Në këtë pjesë të planit përshkruhen shërbimet që ofrohen dhe veprimtaritë që do zhvillohen për t'i shërbyer nxënësve dhe familjeve të tyre. Për shembull, mund të vendosen veprimtaritë/ kurset pas mësimin në fusha të ndryshme të zhvillimit të fëmijës, konsultime dhe përfundim për të nxënësit e nxënësve, vizita në shtëpi dhe veprimtari të përbashkëta me prindërit, seanca trajnimit për stafin apo dhe përfaqësues të komunitetit, etj.

Është e rëndësishme të kuptohet që katër elementët e përmendur më sipër janë thelbi i planit të shkollës – ato formojnë bazën e veprimtarive dhe aktiviteteve ditore në shkollën si qendër komunitare. Hapat e mëposhtëm ndihmojnë për të përcaktuar përgjegjësitë e programit, si dhe për të kuptuar nëse mund të arrihen rezultatet e synuara.

Model i tabelës së veprimtarive të SHQK

	Veprimtaritë	Afatet kohore				Koordinatori i SHQK	Grupet e punës	Faktorët e riskut dhe suksesit
		Maj	Qershor					
1								
2								
3								

Produktet në fund të vitit/periudhës

Në këtë element të planit shënohet të gjithë produktet që do të përftohen nga veprimtaritë e ofruara dhe zhvilluara në shkollë dhe komunitet, ashtu sic janë parashikuar në plan. Zakonisht këto maten si vëllim pune dhe përfshijnë elementë të tillë, si numri i seanceve apo kurseve të zhvilluara, numri i nxënësve të përfshirë në veprimtari të caktuara apo në total, numri i fushave apo tematikave të reja të veprimtarive të zhvilluara, numri i takimeve me prindër apo përfaqësues


të komunitetit të zhvilluara, numri i vizitave në shtëpitë e nxënësve, numri i trajnimeve të ofruara për stafin edukativ apo aktorë të tjerë, etj.

Rezultatet / arritjet e planit

Në plan shënohen rezultatet afatshkurtra të cilat janë ato rezultate që arrihen për një periudhë të shkurtër kur ofrohen veprimtaritë. Këto rezultate mund të përfshijnë njohuritë e fituara nga nxënësit apo prindërit, ndryshimet në qëndrime, fitimin e aftësive dhe shkathtësive ose modifikimin e sjelljeve të cilat lidhen direkt me strategjinë e planit të hartuar.

Shënohen gjithashtu edhe rezultatet afatgjata të cilat maten në nivel shkolle apo komuniteti për një periudhë më të gjatë kohore. Këto rezultate mund të përfshijnë, për shembull, matjet e bëra për të treguar se si kanë ndryshuar rezultatet e nxënësve dhe arritjet e tyre.

Theksojmë faktin se të përfshihesh dhe të synosh shndërrimin e shkollës në një qendër komunitare është shumë e rëndësishme të zhvillosh një plan pune apo veprimtarish. Ai ndihmon shkollën të strukturojë gjithë përpjekjet e saj për të realizuar bashkëpunimin me partnerë si prindërit dhe komuniteti, të koordinojë dhe tërheqë sa më shumë aktorë për përmirësimin e cilësisë së shkollës si dhe të jetë e fokusuar në përmbushjen e synimit për të qenë shkollë komunitare.



Plani i orientuar drejt veprimtarive përballë planit të orientuar drejt rezultateve

Planet e shkollës për tu shndërruar në një shkollë komunitare mund të jenë dy llojesh: 1) Plan i orientuar drejt veprimtarive si shkollë komunitare dhe 2) Plan i orientuar drejt rezultateve. Duke patur parasysh që përfshirja e shkollës në nismën për të qenë një qendër komunitare është një

proces që kërkon burime, aktorë të angazhuar dhe pritshmëri të qarta, arrihet në përfundimin se planet më të mira zhvilluese për shkollën si qendër komunitare janë ato që orientohen drejt rezultateve.

Planet e orientuar drejt veprimtarive, përgjithësisht përfshijnë veprimtari të shtrira në të gjithë shkollën dhe gjatë një periudhe të caktuar. Ato përqendrohen kryesisht te veprimtaritë e shkollës më shumë se sa te rezultatet që do të arrihen. Planet e orientuar drejt rezultateve synojnë përmirësimin apo ndryshimin në njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e sjelljes së të gjithë aktorëve të përfshirë. Planet hartohen në mënyrë të tillë që të ndihmojnë pjesëmarrësit të përmirësojnë apo ndryshojnë në mënyrë pozitive. Ato sigurojnë që strategjitë dhe veprimtaritë që shkolla ofron i përgjigjen problemit që synon të marrë zgjidhje.

Referuar qasjes tonë për shkollën komunitare do të ishte e këshillueshme që fokusi të vihet më shumë në hartimin e planeve që orientohen drejt rezultateve. Megjithatë, një kombinim i të dy llojeve do të rezultonte me një plan më të plotë dhe me ndikim afatgjatë, duke i dhënë mundësi shkollës të përfshihet në një proces tërësor të shndërrimit në një shkollë komunitare.

Tërheqja e të gjithë aktorëve

Është shumë e rëndësishme që kur hartohet plani i shkollës si qendër komunitare i kushtohet rëndësi e veçantë gjetjes së strategjive të përshtatshme për të tërhequr sa më shumë aktorë në komunitet për zbatimin e planit dhe realizimin e veprimtarive të parashikuara në të. Shumë nga aktorët nuk tërhiqen për të marrë pjesë në veprimtaritë e parashikuara nëse nuk janë prezent aq sa duhet në planin e hartuar dhe nëse nuk shohin në të mjaftueshëm atë që do të "korrin" nga kjo pjesëmarrje dhe përfshirje e tyre.

Ata që hartojnë planin mund të përballen me pyetjen: Si do t'i tërheqim dhe do t'i pjesë të planit aktorët që duam që të përfitojnë nga veprimtaritë e ofruara? Për ta zgjidhur këtë duhet që plani të përfshijë:

- Veprimtaritë që ofrohen në plan të jenë me interes për të gjithë aktorët;
- Programi t'i përgjigjet interesave individualë të çdo aktori, si p.sh: disiplinë më e madhe për fëmijët e tyre, dëshirë për të ndihmuar të tjerët, nevojë për zhvillim fizik të fëmijë, etj;

- Kërkohet pjesëmarrje dhe përfshirje e vazhdueshme e aktorëve në veprimtaritë e planifikuara; dhe
- Mbështetje për përfshirjen në veprimtaritë e planifikuara.

Në disa raste ka edhe pengesa që ndikojnë në tërheqjen dhe përfshirjen e sa më shumë aktorëve për zbatimin e planit të hartuar. Më poshtë janë renditur disa nga pengesat e mundshme:

Pengesa në tërheqjen e komunitetit

- Mungesa e një vizioni të qartë.
- Role dhe përgjegjësi të paqarta për stafin mësimor dhe aktorët e tjerë përfaqësues të komunitetit që do të përfshihen.
- Pritshmëri jo të përshtatshme për stafin mësimor dhe pjesëtarët e tjerë të përfshirë në program.
- Qëndrueshmëria e veprimtarive të planifikuara.
- Mos zbatimi i planit ashtu sic është parashikuar në veprimtari dhe afate.
- Mungesa e trajnimit për stafin e shkollës dhe aktorë të tjerë ose trajnim jo i përshtatshëm për ta.
- Mungesa e komunikimit ose e koordinimit.
- Individët e përfshirë nuk e kuptojnë apo nuk janë të qartë sa duhet në lidhje me qëllimin e planit dhe dobitë e tij.

III.AKTORËT DHE PARTNERËT E SHKOLLËS SI QENDËR KOMUNITARE

III.1 Komunikimi dhe bashkëpunimi mes aktorëve brenda shkollës

Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive mes shkollës dhe partnerëve të shkollës kërkon komunikim dhe bashkëpunim mes të gjitha palëve të përfshira.

Bashkëpunimi dhe komunikimi efektiv brenda shkollës është parakusht për bashkëpunim me partnerët e jashtëm. Nëse partnerët jashtë shkollës shohin se ky lloj komunikimi dhe bashkëpunimi mungon në shkollë, krijohen barriera të cilat kushtëzojnë raportet e partnerëve me shkollën dhe venë në diskutim funksionimin e shkollës si qendër komunitare.

Ekipi koordinues i shkollës qendër komunitare, i ngritur pranë çdo shkolle, ka rolin koordinues në sigurimin e bashkëpunimit dhe angazhimit të aktorëve brenda shkollës: nxënës, mësues, drejtues, psikolog shkollor ose punonjës social, dentisti, mjeku dhe pjesëtarë të tjerë të stafit të shkollës. Strukturat dhe organizmat që funksionojnë brenda shkollës, në këtë proces, marrin role dhe detyra të reja, përmbushja e të cilave kërkon bashkëpunimin e ngushtë midis tyre, bashkëpunimin me koordinatorët e DAR/ZA, familjet dhe partnerë të tjerë të komunitetit.

Në gjithë këtë proces të ngritjes dhe funksionimit të shkollës si qendër komunitare, pa dyshim që protagonistët kryesorë, përsa i takon përfitimit nga programet dhe shërbimet e ofruara, por dhe roleve që përmbushin në këtë proces, janë nxënësit.

III.1.1. Organizmat e shkollës

- **Qeveria e nxënësve**

Qeveria e nxënësve është një grup nxënësish të një shkolle, të zgjedhur me votim nga nxënësit e asaj shkolle për t'i përfaqësuar ata dhe pikëpamjet e tyre. Qeveria e nxënësve, megjithëse përbëhet nga një grup nxënësish, në të vërtetë është zëdhënëse e interesave të komunitetit të nxënësve për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të kontribuar në plotësimin e nevojave dhe zhvillimin e interesave të tyre duke synuar një shërbim arsimor sa më cilësor.

Nëpërmjet qeverisë së tyre, qeverisin të gjithë nxënësit e shkollës. Ata përfshihen në zgjidhjen e problemeve të shkollës, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, stafin dhe prindërit, në të mirë të shkollës dhe të vetë nxënësve.

Funksionimi i Qeverisë së nxënësve krijon një mentalitet të ri për pozicionin dhe rolin e nxënësve në shkollë, duke i parë ata si partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Qeveria e nxënësve bashkëvepron me organet kolegjiale të shkollës.

Qeveria e nxënësve planifikon dhe realizon një gamë të gjerë veprimtarish, ndër të cilat:

- *Veprimtari për vlerësimin e nevojave të komunitetit të nxënësve.*

Veprimtari të tilla kanë të bëjnë me përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të nxënësve të drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale. Këtu përfshihen si veprimtari që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit nga nxënësit (me anë të bisedave, vëzhgimeve, pyetësorëve etj.) ashtu edhe veprimtari që kanë të bëjnë me paraqitjen e informacionit të drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale dhe diskutimin me ta.

- *Veprimtari që nxitin një komunikimin më të mirë brenda në shkollë*

Përmirësimi i komunikimit brenda komunitetit të shkollës është një përgjegjësi e përbashkët dhe Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë në këtë proces duke ndërtuar ura komunikimi me nxënësit e shkollës, drejtuesit e shkollës, stafin, dhe prindërit. Këtu përfshihen prezantimi para mësuesve dhe këshillit të prindërve i veprimtarive të kryera, nxjerrja e një gazete etj. Qeveria e nxënësve bashkëpunon me Bordin e shkollës në ato raste kur tematika përfshihet në funksionet e Bordit. Bordi i shkollës jo vetëm dëgjon përfaqësuesit e Qeverisë së nxënësve, por edhe i përgjigjet konkretisht shqetësimeve të saj.

Mbështetja dhe udhëzimet e ofruara nga një mësues janë shumë të dobishme për një Qeveri nxënësish kur planifikon apo organizon veprimtaritë (p.sh. për organizimin e një veprimtarie sportive mund t'i kërkohet mendim mësuesit të edukimit fizik). Nga ana tjetër, anëtarë të Qeverisë së nxënësve është e dëshirueshme të ftohen në mbledhje të personelit mësimor në rastet kur tematika përshtatet me funksionet ose me veprimtarinë aktuale të Qeverisë së nxënësve

- *Veprimtari për të ndihmuar nxënësit e tjerë për përparimin e tyre*

Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë duke propozuar metoda konkrete në funksion të përparimit të nxënësve. Për shembull për të ndihmuar nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të ndihmuar integrimin e nxënësve që fillojnë për herë të parë shkollën ose një nivel shkollimi (p.sh. klasën e 10 në rastin e gjimnazeve) etj.

- *Veprimtari që ndihmojnë mbarëvajtjen e shkollës*

Qeveria e nxënësve mund të japë ndihmesë ë në mënyrë aktive në mbarëvajtjen e shkollës duke formuar grupe të përkohshme pune me nxënës për një çështje të posaçme (për shembull: për disiplinën, për mjedisin etj.) dhe të paraqesë te drejtuesit propozime konkrete. Qeveria e nxënësve mund të propozojë edhe veprimtari jashtë kurrikulare (p.sh. organizimin e konkurseve).

- *Veprimtari që lidhen me ngjarje shkollore sportive dhe kulturore*

Qeveria e nxënësve mund të ndihmojë në organizimin dhe zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve kulturore në shkollë.

- *Veprimtari që lidhen me ndihmesën ose me organizimin e përfuturit të fondeve për bamirësi*

Qeveria e nxënësve mund të organizojë veprimtari si brenda shkollës dhe jashtë shkollës (p.sh. sensibilizimin për një problem që kërkon fonde, shfaqje artistike) me përfshirjen e komunitetit më të gjerë, me qëllim përfuturimin e fondeve për bamirësi të caktuara.

- *Veprimtari që sigurojnë komunikimin me qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera*

Krijimi i një rrjeti të shkollave si qendra komunitare dhe shkëmbimi i përvojave midis tyre kërkon dhe mundëson që Qeveria e nxënësve të një shkolle të bashkëpunojë me Qeveritë e Nxënësve të shkollave të tjera (p.sh. veprimtari të përbashkëta artistike, sportive, projekte të përbashkëta). Në këtë këndvështrim një vlerë të veçantë do të kishte bashkëpunimi me një qeveri nxënësish të formuar rishtazi në favor të kësaj të fundit.

Për realizimin e planeve të saj, Qeveria e nxënësve mund të ndërtojë ura komunikimi e bashkëpunimi me të gjitha organet drejtuese të arsimit në shkollë e më gjerë dhe strukturat kolegjiale të shkollës Qeveria e nxënësve bashkëpunon për probleme e projekte të caktuara me organizata jashtë shkollës, të cilat kanë në fokus të punës së tyre të drejtat e njeriut dhe marrëdhënieve reciproke në përputhje me rregulloren e shkollës dhe rregulloren e Qeverisë së

nxënësve ku janë të përcaktuara detyrat dhe të drejtat e secilit.

- **Drejtuesit e shkollës**

Drejtuesit e shkollës, jo vetëm për funksionin e tyre si përgjegjës të ekipit koordinator të shkollës qendër komunitare, por dhe për rolet që përmbushin në këtë proces, duhet të jenë vizionarë,

planifikues të mirë arsimorë, nismëtarë të zhvillimit të shkollës, komunikues, për të siguruar pjesëmarrje të gjerë të komunitetit, përkrahës për cilësinë në mësimdhënie e mësimnxënie, moderatorë për aktorët kryesor të shkollës, menaxherë për resurset teknike e financiare, udhëheqës për stafin dhe nxënësit e tyre, të cilët marrin vendime të informuara në bazë të të dhënave dhe drejtojnë shkollën në mënyrë efikase e strategjike në një kontekst konkurrues.

Është detyrë e drejtorit të shkollës dhe mësuesve të informojnë prindërit për ngjarje të veçanta, për kalendarin e shkollës dhe për mundësitë që prindërit të takohen me mësues dhe me administratën e shkollës.

Aktivitete të tilla mund të jenë:

- *Ditë të hapura*
- *Aktivitet për të shënuar fillimin e vitit shkollor*
- *Mbrëmje me prindër, organizuar nga kujdestarët e klasave*
- *Aktivitete të tjera shkollore (teatër, muzikë, festa verore, etj.), në të cilat ftohen prindërit.*
- *Etj.*

- **Bordi i shkollës**

Bordi i shkollës përfaqëson një komunitet brenda komunitetit të shkollës, ai është “zëri” i komunitetit në shkollë. Transformimi i shkollës në qendër komunitare nënkupton shndërrimin e shkollës në një institucion tjetër. Sigurimi i qëndrueshmërisë së këtij transformimi kërkon politika që ndihmojnë në menaxhimin e zhvillimit dhe në sigurimin e suksesit. Bordi i shkollës, në bashkëpunim me strukturat e tjera në shkollë, përcaktojnë strategjinë afatgjatë të shkollës si qendër komunitare duke përcaktuar finalitetet dhe veprimtaritë që çojnë në përmbushjen e tyre.

Transformimi i shkollës në qendër komunitare parashtron detyra dhe role të shumta për bordin e shkollës si kontributor në shumë fusha të ndërhyrjeve, të tilla si:

- *Hartimi i politikave të shkollës dhe planifikimi i strategjive*
- *Planifikimi i programeve dhe monitorimi i tyre*
- *Menaxhimi i të dhënave*

III.1.2. Përfshirja e prindërve

Kërkimet dhe përvojat e praktikave të suksesshme kanë provuar se përfshirja e prindërve është çelësi për të ndihmuar fëmijët të jenë të suksesshëm në shkollë. Ata bëhen më të mirë atëherë kur prindërit e tyre kujdesen rreth asaj që ata janë duke bërë në shtëpi, në komunitet dhe në shkollë.

Përfshirja e prindërve në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës është shumë e rëndësishme. Fëmijët mund të arrijnë të shfaqin plotësisht potencialin e tyre në shkollë ose në jetë vetëm kur plotësohen nevojat e tyre fizike dhe emocionale. Ata kanë nevojë që të mësojnë të ndihen mirë me veten e tyre, të mësojnë sesi të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve.

Çfarë është përfshirja e prindërve në shkollë

Në kuptimin e gjerë të fjalës, përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit që të kuptojnë më mirë se çfarë është :

- Prindërimi (të qenit prind)- shprehitë që përdorin prindërit për të ritur dhe edukuar fëmijët e tyre.
- Edukimi i prindërve - informacioni rreth çështjeve që mund të ndikojnë në jetën e fëmijëve të tyre.
- Përfshirja e prindërve në procesin mësimor - rrugët e ndryshme për të mbështetur fëmijët e tyre në shkollë, si dhe për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me procesin mësimor dhe të funksionimit të shkollës

Përfshirja e prindërve në edukim është një koncept i gjerë, sepse shfaqet në shumë forma dhe realizohet në shumë mënyra. Mjaft materiale teorike përshkruajnë role të ndryshme që prindërit mund të luajnë në edukimin e fëmijëve të tyre:

Prindërit si partnerë

Që në momentin e lindjes së fëmijës prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes janë edukatorët e parë dhe kryesorë të tij. Në shtëpi fëmijët mësojnë si të bisedojnë dhe të zhvillojnë aftësitë gjuhësore, mësojnë vlerat, shprehitë sociale si dhe njohuri për shoqërinë.

Prindërit kanë përgjegjësi ligjore për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë si dhe për frekuentimin e rregullt të saj. Ata duhet t'i përgjigjen kërkesave dhe informacioneve të ndryshme që vijnë nga shkolla.

Prindërit kanë të drejtë ligjore të njihen me të gjitha rezultatet shkollore të fëmijëve të tyre, të ndjekin sjelljen e fëmijëve dhe të përfshihen në vendimet që merren për edukimin e tyre.

Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Ndihmon prindërit për të kuptuar përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.
- Jep informacion për:
 - rëndësinë që ka ndjekja e shkollës rregullisht nga fëmija;
 - rregullat dhe procedurat shkollës, duke treguar edhe mënyrat sesi zbatohen ato;
 - programet e shkollës dhe përmbajtjen e fushave të ndryshme kurrikulare.

Prindërit si partnerë dhe zgjidhës të problemeve të shkollës

Prindërit mbështesin punën që bën shkolla me fëmijët e tyre dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve. Prindërit mund të demonstrojnë sesa e rëndësishme është shkolla nëpërmjet disa lloj angazhimesh dhe shfaqje interesash:

- Reagimit të tyre ndaj mungesave, sëmundjeve të lehta të fëmijëve si dhe braktisjeve të shkollës.
- Regullave që ata vendosin për fëmijët e tyre rreth kohës së gjumit dhe asaj për të shikuar televizorin.
- Vlerësimit të rëndësisë së detyrave të shtëpisë.
- Mënyrave sesi ata mbështesin përpjekjet e fëmijëve për të dhënë maksimumin në shkollë.
- Inkurajimit të sjelljeve pozitive të fëmijëve.

Shumë rrallë ndodh që shkolla të zgjidhë e vetme problemet e të nxënësve ose të sjelljes së fëmijëve. Në shumicën e rasteve ju dhe prindërit punoni së bashku për të zgjidhur problemet aktuale që kanë fëmijët në shkollë.

Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Të sigurojë materiale dhe të iniciojë programe apo trajnime, që ndihmojnë prindërit të kuptojnë rregullat dhe procedurat shkollore.
- Të vërë në dukje rëndësinë e komunikimit të prindërve me mësuesit.
- Të vlerësojë rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve në mbedhjet që organizon shkolla.
- Të iniciojë programe për t'u mësuar prindërve sesi t'i ndihmojnë fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Prindërit si vëzhgues

Në këtë rol prindërit ndjekin dhe vlerësojnë veprimtaritë e shkollës dhe të fëmijëve. Veprimtaritë shkollore dhe pas shkolle, si: lojërat, shfaqjet artistike, koncertet, aktivitetet sportive, veprimtaritë letrare, shkencore, etj. janë elemente, të cilat mbushin hendekun ndarës që egziston midis shtëpisë dhe shkollës. Vizitat në klasë i njohin prindërit më mirë me punën që bën mësuesi me nxënësit, me atmosferën e klasës dhe shokët me të cilët kanë miqësi fëmijët e tyre. Në kohën që prindërit qëndrojnë në shkollë për të dëgjuar dhe vëzhguar fëmijët e tyre ata mund edhe të mbledhin informacion për veprimtaritë e shkollës dhe njerëzit me të cilët fëmijët e tyre harxhojnë një pjesë të kohës. Me rëndësi është fakti që në këto vizita fëmijët në përgjithësi dhe ata me rezultate të ulta në veçanti, ndihen mirë që prindërit e tyre tregojnë interes për shkollën, mësuesit dhe klasën e tyre.

Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Merr pjesë në planifikimin dhe njoftimin e veprimtarive të shkollës, duke ua bërë të njohura prindërve.
- Bën prindërit pjesë të veprimtarive si dhe takimeve që zhvillon stafi mësimor ose klasa.
- Organizon veprimtari të ndryshme duke vendosur një plan të alternuar për orarin, ditët e pushimit dhe mbasditet për t'u dhënë mundësi të gjithë prindërve të ndjekin këto veprimtari.

Prindërit si vullnetarë

Në këtë rol prindërit punojnë si vullnetarë në ndihmë të shkollës, mësuesve, bordit të shkollës, këshillit të prindërve, etj. Në shumë praktika të sukseshme ka një traditë që prindërit të punojnë vullnetarisht në ndihmë të mësuesve të fëmijëve të tyre dhe të shkollës në tërësi.

Prindërit si këshillues dhe partnerë në vendimmarrje

Prindërit japin ndihmesën e tyre në politikën e shkollës dhe planet e programet shkollore nëpërmjet pjesëmarrjes si në bordin e shkollës dhe në institucionet ato vendimmarrëse. Shumë prindër marrin pjesë në bordin e shkollës, këshillin e mësuesve duke krijuar mundësinë që të lidhen me problemet e shkollës dhe veprimtaritë që realizohen aty. Kjo i bën që të kenë një autoritet real në vendimmarrje. Sot ka një prirje për t'i përfshirë prindërit në bordet e shkollës me synimin që ata të marrin vendime për çështje të ndryshme të shkollës si dhe për emërimin e stafit mësimor.

Kur prindërit kalojnë nga roli i një këshilluesi në atë të një vendimmarësi atëherë ata kanë nevojë për më shumë informacion. Ata kanë nevojë të mësojnë teknika për të bërë pjesë të vendimarrjes problemet që janë ngritur në komunitet nga prindërit. Trainimet e prindërve janë të vlefshme, sepse ata do të njohin më mirë programet edukative të shkollës dhe do të jenë të ndieshëm ndaj nevojave arsimore të fëmijëve dhe prindërve në komunitetin e tyre shkollor.

Formimi i partneritetit shkollë-familje

Sot kërkohet që çdo shkollë në qytet apo në fshat të hartojë një politikë të caktuar për përfshirjen e prindërve në edukim. Hartimi i një politike dhe një plani për përfshirjen e prindërve në edukim si dhe zbatimi i tyre ka shumë rëndësi, sepse nga kjo gjë përfitojnë fëmijët, shkolla dhe prindërit. Sidoqoftë edhe në rastet kur në shkollë ekziston një politikë dhe plan zhvillimi për partneritetin shkollë-familje, ajo që ka rëndësi është se çfarë ndodh aktualisht në këtë shkollë.

Për të hartuar një plan për zhvillimin e partneritetit shkollë-familje:

- Komunikoni me gojë ose me shkrim me çdo prind për të parë se çfarë mendojnë ata për shkollën dhe se çfarë do të pëlqenin të përmbanin programet e përfshirjes së tyre në edukim.
- Mësoni sesi e kuptojnë anëtarët e bordit të shkollës dhe vetë stafi i shkollës përfshirjen e prindërve në edukim.
- Vlerësoni programet aktuale që ka shkolla për përfshirjen e prindërve në shkollë dhe mënyrën sesi funksionojnë ato, duke i vendosur veprimtaritë në një plan për zhvillimin e partneritetit shkollë - familje.

Grumbulloni informacion për t'u përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- A ka organizuar shkolla juaj një politikë apo strategji për përfshirjen e prindërve në edukim?
- A ka programi juaj një shpërndarje të barabartë të mundësive për të përfshirë të gjitha kategoritë e prindërve në edukim? Në qoftë se jo cila nga kategoritë e prindërve kërkon më shumë mbështetje?
- A janë përfshirë në programin tuaj prindër që përfaqësojnë çdo grup të madh familjar të komunitetit të shkollës ?
- A janë përfshirë në programin tuaj prindër që kanë fëmijë në klasa të ndryshme apo prindër vetëm nga një klasë?

Për të ndihmuar në formimin e partneritetit shkollë-familje:

1. Puno për hartimin e një politike për përfshirjen e prindërve në edukim. Ndiemo që politika e përfshirjes së prindërve në edukim të zbatohet në shkollën tuaj.
2. Bëni një fushatë për përfshirjen e prindërve në edukim. Përfshini në këtë fushatë prindër dhe nxënës.
3. Pyesni prindërit se çfarë programesh ose seminaresh kanë interes të ndjekin. Kini parasysh që problemi qëndror është të ndihmohet prindi për t'u bërë më efektiv në punën me fëmijët. Programet mund të përfshijnë veprimtari që ndihmojnë prindërit për të rritur aftësitë e tyre në rolin e prindit apo për të siguruar informacione rreth çështjeve, të cilat kanë lidhje me komunitetin e prindërve.
4. Siguroni libra me temë për punën me prindërit dhe vendosi këto libra në bibliotekë ose në klasat e shkollës. Ftoni prindërit që të marrin librat ose të kërkojnë materiale të tjera.
5. Në qoftë se ka mjedise fizike në shkollë, hapni një dhomë për prindërit dhe vendosni literaturën për ta, siç u tha më sipër. Ftoni njerëz nga shkolla apo komuniteti për t'u lidhur me veprimtari të edukimit të prindërve. Përdorni dhomën si një vend që u shërben nevojave të prindërve.
6. Mendoni mënyra për të tërhequr të gjithë prindërit në shkollë. Përdor prezantimet verbale dhe vizuale për të qartësuar informacionin teorik.

Kur prindërit përfshihen në edukimin e fëmijëve, atëherë fëmijët kanë rezultate më të mira në mësim. Nuk ka nevojë që prindërit të kenë një arsimim të lartë. Ajo që nevojitet është që ata të krijojnë një atmosferë familjare, që u thotë fëmijëve të tyre se shkollimi është i rëndësishëm dhe se ata kërkojnë që fëmijët të mësojnë mirë, për këtë ata do t'i ndihmojnë në shkollë dhe në shtëpi.

Mësuesit në ndihmë të sigurimit të partneritetit me prindërit

Çfarë mund të bëni ju si mësues që shkolla dhe prindërit të komunikojnë vazhdimisht me njëri tjetrin?

Kërkoni nga prindërit që:

- Kur ka ndonjë kërkesë nga shkolla ta plotësojnë atë dhe ta dërgojnë përsëri në shkollë. Stafet e shkollës ka nevojë të dëgjojnë mendimet e prindërve.
- Të informojnë shkollën për gjërat, që u ndodhin në shtëpi dhe që mund ta bëjnë fëmijën të jetë i mërzitur apo i zemëruar në shkollë.
- Jepini prindit informacion rreth veprimtarive që bëhen në shkollë. Tregoni se kur bëhen ato dhe për çfarë bëhen.

Çfarë mund të bëjë prindi për fëmijën dhe për shkollën?

- Krijoni kushte për një zhvillim të mirë fizik dhe emocional të fëmijës suaj.
- Krijoni një mjedis të tillë në shtëpi që të tregoni se shkollimi vlerësohet dhe inkurajoni procesin e të mësuarit.
- Krijoni në shtëpi një atmosferë që inkurajon respektin e dyanshëm dhe komunikimin.
- Merr pjesë si vullnetar në shkollë ose në klasën e fëmijës tuaj në veprimtari të ndryshme.
- Ndiqni të gjitha vprimtaritë e shkollës.

Çfarë mund të bëni ju si mësues?

Ndihmoni prindërit:

- Të njohin programin e shkollës: çfarë mëson fëmija në shkollë, pse dhe si si funksionon sistemi shkollor, si mund ta ndihmojë fëmijën të mësojë dhe të njohë të drejtat, si dhe përgjegjësitë prindërore.
- Të mësojnë sesi ndodh zhvillimi fizik, mendor dhe social i fëmijës nga foshnjëria gjer në moshën e rritur.
- Të kenë të qartë se çfarë presin nga fëmijët e tyre dhe si do të njoftohen për përparimin e tyre.
- U kujtoni prindërve se ata janë mësuesit e parë dhe më të rëndësishëm që i pajisin fëmijët me shprehitë që u duhen atyre në jetën e përditshme si: përgjegjësia, vendosmëria, shprehitë për t'u shoqëruar me të tjerët etj.
- Kërkoni nga prindërit që t'ju japin informacion për fëmijët e tyre si dhe për eksperiencat të tjera që mund t'ju interesojnë
- U kërkoni prindërve që t'ju bëjnë të qarta nevojat që ata kanë
- Inkurajoni prindërit që të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe në zgjidhjen e problemeve që ka shkolla. Në qoftë se zëri i prindërve nuk dëgjohet shumë në shkollë dhe prindërit e interesuar nuk kanë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë efektive në punët e saj bisedoni me drejtorin për të iniciuar veprimtari, që çojnë në një përfshirje më të madhe të prindërve në punët e shkollës.

MODELE MATERIALESH NË NDIHMË TË FORMIMIT TË PARTNERITETIT SHKOLLË-FAMILJE

PYETËSOR

(Për edukimin e prindërve)

Me anë të këtij pyetëtori shkolla dhe mësuesit synojnë të njohin nevojat e prindërve me qëllim që të organizojnë trainime me ta.

Unë jam i interesuar në çështjet e mëposhtme:

- _____ Të mësoj sesi të ndihmoj fëmijën në lexim. Klasa _____
- _____ Të mësoj sesi të ndihmoj fëmijën në matematikë. Klasa _____
- _____ Si të bisedoj me fëmijën tim për problemet e seksit.
- _____ Si të bisedoj me fëmijën tim për SIDA apo sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
- _____ Si të parandalojmë abuzimet me alkool, duhan , drogë.
- _____ Si të disiplinoj fëmijën në mënyrë të përshtatshme.
- _____ Si ta ndihmoj fëmijën në detyrat e shtëpisë.
- _____ Si të komunikoj me fëmijën tim.
- _____ Si ta mësoj fëmijën që të vlerësojë veten.
- _____ Ta mësoj fëmijën tim të marrë vendime e të jetë përgjegjës për këto vendime.

Përmendni edhe probleme të tjera, që nuk janë përfshirë:

Ditët më të mira për të ndjekur seminarët janë :

E hënë _____, e martë _____, e mërkurë _____, e enjte _____, e premte _____, e shtunë _____.

Ora më e përshtatshme _____

Për më tepër informacion mund të më kontaktoni në:

Emri _____

Telefoni _____

Adresa _____

MODEL I NJË MARRËVESHJEJE MES NXËNËSIT, PRINDIT, MËSUESIT DHE DREJTORIT TË SHKOLLËS

Partnerë në procesin e të nxënit

Sot të gjithë e dinë që fëmijët mësojnë nga të riturit. Dashuria, kujdesi, inkurajimi, mjedisi i ngrohtë etj. janë elemente të rëndësishme për një zhvillim sa më të mirë të çdo fëmije. Ne jemi të përkushtuar që të punojmë së bashku dhe të bëjmë përpjekjet tona maksimale për ndihmuar që nxënësi _____ të dalë me përfundime sa më të mira.

Si nxënës unë marr përsipër:

- Të punoj sa më shumë që të jetë e mundur në të gjitha lëndët.
- T'u tregoj prindërve se çfarë po mësoj në shkollë.
- Të kërkoj ndihmë nga mësuesi kur nuk kuptoj ndonjë gjë në mësim.
- Të zbatoj rregulloren e shkollës.
- Të kufizoj kohën për të parë televizor dhe në vend të kësaj të bëj mësimet.

Nënshkrimi i nxënësit

Si prind unë marr përsipër:

- Të krijoj një mjedis ku fëmija im të studiojë i qetë dhe të kujdesem që ai të mësojë sistematikisht.
- Të flas me fëmijën për veprimtaritë e tij çdo ditë.
- Të di sesi po përparon fëmija im në mësim, të marr pjesë në takimet me prindër, të shikoj detyrat e shtëpisë dhe të angazhohem në punët e shkollës.
- Të inkurajoj fëmijën tim të lexojë duke e ndihmuar atë edhe përmes shembullit tim.
- Të kufizoj kohën që fëmija im përdor për të parë emisionet televizive dhe ta orientoj atë që të shohë programe të përshtatshme për të.

Firma e prindit

Si mësues unë marr përsipër:

- T'i nxis dhe motivoj nxënësit për të përmirësuar procesin e të nxënit.

- T'u bëj të qartë nxënësve dhe prindërve synimet dhe mënyrat e mia të vlerësimit.
- Të përdor metoda dhe materiale mësimore, që janë të përshtatshme për çdo nxënës.
- T'u shpjegoj prindërve dhe nxënësve rregulloren e shkollës.
- Të punoj me çdo prind për të siguruar një arsimim sa më të mirë të fëmijëve të tyre.

Nënshkrimi i mësuesit

Si drejtor shkolle unë marr përsipër:

- Të krijoj në shkollë një mjedis mikpritës për nxënësit.
- Të bisedoj me prindërit dhe nxënësit dhe t'u bëj të qartë misionin dhe synimet që ka shkolla.
- Të siguroj që mjedisi shkollor të jetë i sigurtë dhe i përshtatshëm për të mësuar.
- Të inkurajoj lidhjet midis prindërve, nxënësve dhe mësuesve.
- Të organizoj një sistem trajnimi brenda shkollës si për mësuesit ashtu edhe për prindërit

Nënshkrimi i drejtorit

Ne premtojmë të punojmë së bashku për të ndihmuar njëri - tjetrin me anë të kësaj marrëveshje.

Nënshkruar më _____

PYETËSOR

(Me anë të pyetësorit të mëposhtëm, që u shpërndahet prindërve, mësuesit bëjnë përzgjedhjen e atyre që dëshirojnë të punojnë si vullnetarë në ndihmë të shkollës):

Fëmijët mësojnë nga të riturit, të cilët kujdesen për ta. Duke u ofruar fëmijëve kohën, talentin dhe aftësitë tuaja ju do të ndihmoni jo vetëm shkollën, por edhe fëmijët tuaj që të mësojnë më mirë. Ju lutemi, kur të keni kohë, të ndihmoni shkollën në gjërat e mëposhtme:

____ Unë do të doja të punoja si vullnetar në ndihmë të mësuesve në shkollë. Ju lutem më njoftoni se me çfarë mund të merrem.

____ Unë punoj si _____ dhe jam i gatshëm t'u flas nxënësve për punën time

____ Unë kam jetuar/udhëtuar në shtetin e _____ dhe do të kisha kënaqësinë tu flas nxënësve për këtë shtet.

____ Unë do të doja t'u flas nxënësve për interesa e mia në fushën e _____.

Unë dëshëroj që të ndihmoj nxënësit që kanë nevoje në:

____ Lexim (klasa _____)

____ Matematikë (klasa _____)

____ Gjuhë e huaj (klasa _____)

____ Unë mund t'i stërvis nxënësi në _____ (përmend llojin e sportit).

____ Unë do të doja t'i ndihmoja nxënësit :

€ në mësimin e kompjuterit,

€ në punime arti,

€ në qepje,

€ në vizatim.

Koha më e mirë për të kontaktuar me mua është _____

Emri _____ Telefoni _____

Adresa _____

**FORMULAR PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE TË MËSUESIT PËR PRINDËR
VULLNETARË**

Emri i mësuesit _____ **data** _____

Klasa _____ **lënda** _____

Unë do të dëshiroja që një prind vullnetar të më ndihmojë në detyrat e mëposhtme:

- € për mësimin e qepjes dhe gatimit,
- € për zhvillimin e eksperimenteve.
- € për organizimin e bisedave në klasë,
- € për të mbledhur materiale për punën mësimore,
- € për të organizuar ekskursione apo vizita,
- € për gjëra të tjera _____.

Unë do të doja që një prind vullnetar të më ndihmojë në këto detyra:

- € të dëgjojë dhe të ndihmojë një nxënës që lexon,
- € të japë ndihmë individuale,
- € të ndihmojë një nxënës në mësimin e gjuhës së huaj,
- € të ndihmojë në mësimin e matematikës,
- € të tjera si : _____.

Unë do të doja që një vullnetar të punonte me klasën ose me një grup të vogël në lidhje me këto detyra:

- € të ndihmojë për gazetën e shkollës,
- € të ndihmojë në mësimin e muzikës,
- € të kujdeset për nxënësit kur bëjnë ekskursione ose kur marrin pjesë në mbrëmje,
- € të flasë me nxënësit për llojet e profesioneve,
- € të organizojë lojra me nxënësit,
- € t'u tregojë nxënësve historira.

Unë do të dëshiroja që prindërit vullnetarët të vijnë në ditët:

Mëngjes: e hënë____, e martë____, e mërkurë_____.

Pasdite: e enjte____, e premte_____.

Kërkesat ndaj prindit vullnetarë:

- Të ketë dëshirë të punojë me fëmijë.
- Të ndjekë trajnime mbi rritjen e aftësive si tutor në klasë për lëndë të ndryshme.
- Të njoftojë mësuesin në qoftë se është i pazoti të ndihmojë për një detyrë të dhënë në një moment të caktuar.
- Të ruajë sekretin për informacionin rreth nxënësve dhe stafit të shkollës.

Letra prezantuese e mësuesit

Letrat prezantuese që mësuesit u dërgojnë prindërve para ditës së parë të shkollës ose në fillim të saj fuqizojnë shumë lidhjen shkollë-famijle. Prindërit kënaqen kur mësuesit janë iniciatorë të vendosjes së kontakteve mes tyre. Kjo bën që ata ta kenë më të lehtë të takohen me mësuesit, sepse, tashmë, kanë një njohje me ta. Për të inkurajuar komunikimin e dyanshëm letrat duhet të përmbajnë një pjesë, që mund të shkëputet lehtësisht nga ana e prindërve. Këtë prindërit duhet t'ua kthejnë mësuesve. Nëpërmjet saj jepet informacion për mënyrën sesi të kontaktojnë mësuesit me prindërit në telefon, për vendin e takimit etj. Po kështu, në këtë pjesë të letrës, prindërit mund t'u kërkojnë mësuesve ndihmë për probleme të ndryshme.

Letra prezantuese ose e mirëseardhjes mund të përmbajë:

- informacion prezantues për mësuesit;
- numrin e telefonit të mësuesit në shkollë dhe orët e qëndrimit në shkollë;
- komente për rolin e rëndësishëm që luajnë prindërit në edukimin e fëmijëve të tyre;
- përshkrimi i procedurave të punës në klasë;
- kërkesat për detyrat e shtëpisë dhe informacion për sistemin e vlerësimit;
- lista e leximeve ose projekteve;
- Informacione për aktivitetet e ardhshme prind –mësues;
- sugjerime për mënyrat sesi prindërit mund të ndihmojnë mësuesin.

Studimet tregojnë që në shkollat efektive prindërit janë vazhdimisht të informuar rreth progresit të nxënësit dhe mënyrave sesi ata mund të mbështesin përpjekjet e fëmijëve të tyre.

Prindërit mund të jenë efektivë në ndihmën që u japin fëmijëve të tyre vetëm nëse informohen rregullisht çdo ditë, çdo javë ose në mënyrë periodike shumë kohë më parë se të dalë dëftesa e notave.

Detyrat e shtëpisë janë një mjet tjetër i vlefshëm komunikimi. Ato i lejojnë prindërit të shohin se çfarë janë duke mësuar fëmijët e tyre në shkollë dhe se çfarë suksesesh dhe vështirësish janë duke ndeshur në punën mësimore. Gjatë takimeve me prindërit ose kontakteve me letra mësuesit mund t'u tregojnë prindërve sesi duhet të bëhen detyrat në shtëpi.

NJË MODEL LETRE PREZANTUES NGA ANA E MËSUESVE

Të dashur prindër,

Unë quhem ----- dhe jam mësuesi kujdestar i fëmijës tuaj. Dëshëroj që të jetë një vit shkollor i suksesshëm për ju dhe fëmijën tuaj. Është në të mirën e fëmijës suaj që ne të punojmë së bashku. Shpresoj që ne do ta njohim njëri - tjetrin më mirë gjatë vitit shkollor.

Unë po ju dërgoj një informacion të shkurtër rreth personit tuim, i cili mund të ketë interes për ju:

Jam i martuar dhe kam _____ fëmijë në moshën _____ vjeç. Kam mbaruar universitetin në degën e _____ dhe banoj në _____. Jam mësues që prej _____ vitesh. Në kohën e lirë më pëlqen të merrem me _____.

Unë do të kontaktoj herë pas here me ju për të biseduar rreth fëmijës tuaj. Do t'u dërgoj në shtëpi një plan të detyrave të shtëpisë që nga e marta deri të premten. Ju lutem ndihuni të lirshëm të kontaktoni me mua në qoftë se keni ndonjë pyetje apo nevojë për informacion të mëtejshëm. Numri im i telefonit në shkollë është _____ dhe koha më e mirë për të më telefonuar është nga _____ deri në _____.

Mua më pëlqen që prindërit ta vizitojnë klasën time të paktën një herë në secilin semestër. Natyrisht ju jeni të mirëpritur të vini në çdo kohë. Unë shpresoj që ju të na vizitoni shpesh.

Pas pak javësh do të organizoj një takim me prindërit. Unë ose një anëtar i bordit të prindërve do të kontaktojë me ju për t'ju thënë orën dhe datën e saktë të mbledhjes. Po pres me shumë interes që t'ju takoj personalisht sa më shpejt që të jetë e mundur.

Me respekt

----- *Ju lutem griseni këtë pjesë dhe ma dërgoni të plotësuar*-----

Unë do të doja t'ju takoja ju në mbledhjen me prindërit që do të organizohet në datën _____ në orën _____

Emri i nxënësit _____

Firma e prindit _____

**NJË MODEL LETRE ME ANË TË SË CILËS PRINDËRIT PREZANTOJNË
VETVETEN**

Z/Znj_____

Fëmija im_____ sivjet do të jetë në klasën tuaj. Ne dëshirojmë të punojmë së bashku me ju që fëmija jonë të ketë suksese në mësimet.

Ju mund të lidheni me ne në telefon me këtë numër_____ pas orës _____. Po ashtu mund të lidheni me ne gjatë ditës me numrin e telefonit të punës_____. Ne do t'u ishim shumë mirënjohës nëse ju do ta na njoftoni për çdo gjë që lidhet me fëmijën tonë gjatë vitit shkollor.

Unë pres me shumë interes që t'ju takoj ditët e takimit me prindërit.

Me respekt

Prindi

Z/Znj_____

Unë kam mësuar se ju jeni mësues kujdestar në klasën ku mëson fëmija im_____. Ai e ka me shumë dëshirë shkollën dhe do ta vazhdojë edhe më tej, prandaj ju lutem që ta inkurajoni në këtë drejtim

Unë do t'ju isha mirënjohës po të më telefononi nëse ka ndonjë gjë që unë duhet të di lidhur me fëmijën tim. Ju mund të më kontaktoni duke më telefonuar në telefonin e shtëpisë_____ në darkë ose në telefonin e punës_____ gjatë ditës.

Me respekt

Prindi

III.1.3. Komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetin

Bashkëpunimi me komunitetin konsiderohet si një ndërveprim që bashkon anëtarët e disa grupeve (sociale, profesionale etj) për një qëllim të përbashkët përmes një procesi komunikimi dhe vendimmarrje të përbashkët. Ky bashkëpunim e bën shkollën më të hapur e demokratike, përmirëson cilësinë e punës në shkollë, i shërben fuqizimit të shkollës, familjes dhe komunitetit. Zhvillimi i një bashkëpunimi afatgjatë me komunitetin kërkon vizion dhe kohezion në politikën e shkollës, kërkon një qasje gjithëpërfshirëse për të mbështetur dhe përmirësuar të nxënit e nxënësve, zhvillimin e tyre të shëndetshëm, për të forcuar familjet dhe komunitetin.

Ky bashkëpunim kërkon vullnetin e të gjithë partnerëve për të qenë pjesë e një ekipi. Ai nuk duhte të jetë i imponuar apo i sforcuar dhe kërkon barazi midis partenërve. Në këtë kuptim përfaqësuesit e komunitetit nuk janë thjesht ‘zbatues’ të vendimeve që merr shkolla në lidhje me programet apo shërbimet e ndryshme për nxënësit e familjet e tyre, por përfaqësuesit e komunitetit janë vendimamarrës të përbashkët, ndajnë bashkë burimet dhe interesa të përbashkëta.

Nga përvoja e drejtpërdrejtë, nëpërmjet përfshirjes në veprimtari të përbashkëta, familjet dhe anëtarët e tjerë të komunitetit mund ta ndiejnë përgjegjësinë personale në procesin e marrjes së vendimeve, të cilat do të ndikojnë jo vetëm mbi jetën e fëmijëve të tyre, por edhe mbi jetën e të gjithë fëmijëve të komunitetit.

Përfitimet e partneritetit me komunitetin

- Një partneritet i suksesshëm ndikon në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Përmes këtij bashkëpunimi, të nxënit e nxënësve lidhet me situata të jetës reale dhe mbështetet zhvillimi i kompetencave që u shërbejnë përgjatë gjithë jetës.
- Partneriteti shkollë-komunitet i shërben përmirësimit të politikave, programeve dhe strukturave të shkollës.
- Partneriteti shkollë-komunitet i shërben komunitetit për përmirësimin e shërbimeve të tyre.

Plani i veprimit për zhvillimin e partneritetit me komunitetin

Plani i veprimit për zhvillimin e partneritetit me komunitetin realizohet përmes disa fazave:

Faza 1: Prezantimi dhe përcaktimi i qëllimeve

Krijimi i partneritetit me komunitetin përfshin:

1.1 Identifikimin e aktorëve

Partnerë potencialë të komunitetit mund të jenë:

- Biznesi (biznesi lokal, kompani të mëdha etj);
- Universitetet dhe institucione arsimore (shkolla publike dhe private, institucione të tjera arsimore etj);
- Organizata të kujdesit shëndetësor (spitale, qendra shëndetësore, organizata që punojnë për shëndetin);
- Institucione të qeverisjes (vendore), (qendrore – policia, zjarrfikësit, dhoma e tregtisë, institucione të tjera);
- Institucione kulturore (muze, biblioteka, galeri arti, teatër, etj);
- Organizata me bazë vullnetare;
- Organizata të ndryshme sportive (klube sportive);
- Media (gazeta lokale, radio dhe televizioni lokal etj);
- Shërbime sociale;
- Individë nga komuniteti;
- Etj.

1.2 Përcaktimin e qëllimeve të përbashkëta

Komuniteti mund të mbështesë shkollën për zhvillimin e veprimtarive të cilët mund të kenë fokuse të ndryshme.

Tabela e mëposhtme përcakton katër fushat e këtij fokusi dhe një listë të veprimtarive për secilën fushë.

Me në qendër nxënësin	Me në qendër familjen	Me në qendër shkollën	Me në qendër komunitetin
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mentorim ▪ Bursa studimi ▪ Formim për punë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ëorkshope me prindër ▪ Klasa për arsimin e të rriturve ▪ Këshillime ▪ Mbrëmje për prindërit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Materiale dhe pajisje ▪ Incentiva për mësuesit ▪ Fonde për shkollën apo për evente të ndryshme ▪ Asistencë në klasë apo për shkollën (drejtuesin) 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Programe për komunitetin ▪ Mbrëmje me tematika të ndryshme ▪ Veprimtari për anëtarë të komunitetit

1.3 Vendosjen e konsensusit dhe ndërtimin e lidërshiptit të përbashkët

Për një partneritet të suksesshëm shkollë-komunitet, partnerët duhet të vendosin qëllime të përbashkëta, përfshirë strukturat vendimmarrëse (ekipi për koordinimin e SHQK, bordi i shkollës) dhe të shpenzojnë kohë së bashku për të reflektuar dhe vlerësuar programet dhe planifikimet.

Faza 2: Vlerësimi i situatës dhe i alternativave

Kjo fazë përfshin;

- Vlerësimin e nevojave të komunitetit;
- Identifikimin e burimeve të komunitetit;
- Identifikimin e pengesave të mundshme;

Faza 3: Planifikimi i veprimtarive

Kjo fazë përfshin planifikimin e veprimtarive (hartimi i një plani një vjekar veprimtarish në të cilin përcaktohen veprimtaritë, personat përgjegjës, grupet përfitues, afatet, sfidat e mundshme)

Veprimtaritë mund të orientohen në fusha të tilla, si:

Komuniteti si burim për përmirësimin e kurrikulës

Komuniteti ofron shumë mundësi për përmirësimin e kurrikulës, p.sh., në zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle, për zhvillimin e temave të veçanta në matematikë, fizikë, biologji, arte etj.

Shkolla si burim për të përmirësuar të nxënit e komunitetit

Jo vetëm komuniteti ofron shërbime për shkollën, por shkolla mund të ofrojë shërbime për anëtarët e komunitetit, si p.sh., kurse kompjuteri, palestër, programe për ushqyerjen etj.

Komuniteti ofron shërbime për shkollën

Komuniteti ofron programe mentorimi për shkollën, p.sh., servis makinash, module profesionale etj., gjithashtu mund të ofrojë shërbime për mësuesit, programe trajnimi për zhvillimin profesional.

Shembuj shërbimesh të ofruara nga komuniteti:

- Spitali i qyteti apo një qendër shëndetësore mund të ofrojë trajnime për prindërit për terapi fizike të fëmijëve me nevoja të veçanta, apo biseda për duhanin, drogën, marrëdhëniet seksuale në moshë të hershme etj..
- Universitetet ofrojnë trajnime apo biseda me prindërit/mësuesit për tema të ndryshme?
- Muzetë, galeritë e ndryshme të artit figurativ mund të ndihmojnë në zbatimin e mësimdhënies në lëndën e vizatimit.
- Bibliotekat e qytetit mund të venë në dispozicion burimet e tyre dhe mjediset për zhvillimi e orëve të leximit, apo diskutimit të librave.
- Biznesi mund të ofrojë programe mentorimi për nxënës të veçantë.
- Etj.

IV. Të shkosh në shkollë me dëshirë është një hap i rëndësishëm për jetën e çdo nxënës

Vajtja në shkollë është një hap i rëndësishëm për nxënësit dhe në mënyrë të veçantë për të vegjlit që shkojnë në shkollë për herë të parë. Për këta fëmijë shkolla është si një zbulim që do t'u shërbejë gjatë gjithë jetës. Shkolla duhet të shërbejë për të gjithë nxënësit si një sistem që valorizon karakterin e gjithsecilit, diversitetin e të gjithë nxënësve dhe mësuesve, dhe mundohet t'i ofrojë një edukim efektiv gjithsecilit. Para se shkolla të fillojë, është shumë e rëndësishme që prindërit të marrin kohë për të qenë prezent në shkollë bashkë me fëmijën, në mënyrë që së bashku të bashkëbisedojnë për mbarëvajtjen e vitit akademik.

Në paragrafin në vijim ne shprehim disa pritshmëri të para që prindërit mund të kenë ndaj shkollës për ecurinë sa më të mirë të nxënësit në shkollë.

Aktivitetet që realizohen në shkollë	Aktivitetet që realizohen në shtëpi
<p>Fëmijët mundet të:</p> <ul style="list-style-type: none">• Zgjedhin aktivitete të ndryshme, dhe materiale të ndryshme pune gjatë kurseve të zhvilluara mbas mësimit.• Fëmijët bashkëpunojnë me fëmijët e tjerë dhe ndajnë materialet dhe hapësirën me njëri-tjetrin.• Përshtaten me personat e rinj, situatat e ndryshme dhe aktivitetet rutinë.• I komunikojnë nevojat e tyre të rriturve ose fëmijëve të tjerë.• Mësohen me faktin se ata mund t'u shkruajnë të rriturve për nevojat e tyre, duke përdorur, laps, stilolaps apo materiale të tjera.• Dëgjojnë poemat, librat informativ dhe çdo informacion të rëndësishëm që lexohet nga fëmijët e tjerë ose të rriturit.	<p>Prindërit duhet të kenë parasysh!</p> <ul style="list-style-type: none">• Ndhimoheni fëmijën të jetë i lirshëm që të ketë mundësi të zgjedh edhe në shtëpi (p.sh veshjet, ambientin ku realizon detyrat,...)• Afrojini mundësinë që të jetë në kontakt me fëmijët e tjerë, të mësojë të bashkëpunojë, të ndajë objektet e tij me të tjerët, të jetë i durueshëm, të presë radhën kur është e nevojshme.• Inkurajoheni të shprehet, të gjej fjalët e duhura për zgjidhjen e nevojave apo problemave të ndryshme.• Ngjallini interesin e të shkruarit, p.sh të shkruaj karta, të krijojë skema apo grafikë që e ndihmojnë në të kuptuarin e teorive të marra në shkollë.• Thojini fjalë inkurajuese dhe motivuese sa herë ai realizon sakte aktivitetet.• Lexojini libra që kanë interes dhe ndihmoheni që ai të ketë interes të lexojë informacione që i nevojiten jo vetëm për në shkollë por edhe për jashtë saj.

Prindi është i pari dhe më i rëndësishmi në edukimin e fëmijës.

Objektivat në qendër të filozofisë së programit Shkolla Qendër Komunitare

Të krijohen kontakte ndërmjet shkollës, komunitetit, dhe organizatave jo fitimprurëse dhe aktorëve të tjerë të interesuar për arsimin për ti ofruar fëmijëve por dhe prindërve sa më shumë burime që nxisin zhvillimin e nxënësve.

Ti ofrohen prindërve programe dhe aktivitete cilësore duke marrë parasysh origjinat e ndryshme kulturore, etnike dhe gjuhësore.

Prindër bashkëpunojnë me fëmijët në ambientet e shkollës për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta arsimore.


T'u ofrohen nxënësve mundësitë për të qenë pjesë e aktiviteteve që rrisin performancën e tyre shkollore, dhe përmirësojnë zhvillimin e tyre social dhe afektiv.

T'u ofrohet mundësi prindërve që të vëzhgojnë aktivitetet që lidhen me hapat e zhvillimit të fëmijëve por dhe nevojat e fëmijëve.

Për arritjen e objektivave është e rëndësishme që shkolla të organizojë një vlerësim të aktiviteteve që ofron, në mënyrë që prindërit të thonë fjalën e tyre në lidhje me pritshmëritë që ata kanë ndaj programit të Shkollës Qendër Komunitare. Për vlerësimin e aktiviteteve do të përdoren matricat të cilat i gjeni në vijimësinë e këtij dokumenti.

Organizimi i Shkollës Qendër Komunitare

SHKOLLA



IV.1. Bashkëpunimi komunitar


Roli i mësuesit/es kujdestar/e dhe shkollës

Është e rëndësishme që **mësuesi/ja kujdestar/e e klasës** të njoftojë në fillim të vitit shkollor çdo prind në lidhje me pritshmëritë që ajo ka, dhe mënyrën se si prindërit do të kontribuojnë në mbarëvajtjen e aktiviteteve të SHQK.

Shkolla harton listën e aktiviteteve që ofron gjithashtu dhe përshkrimin e detajuar të secilit aktivitet në varësi të nevojave të shkollës, dhe ua dërgon prindërve në fillim të vitit. Në këtë

mënyrë prindërit njihen me listën dhe përzgjedhin paraprakisht. Kjo ndihmon shkollë të ketë të përgatitur tashmë listën e nevojave të komunitetit, për t'i ofruar atyre ndihmë sa më të mirë gjatë vitit akademik.

Portofol informues në kujdes të prindërve dhe komunitetit



Kontaktimi i prindërve në fillim të vitit shkollor. (Informimi i prindërve bëhet 2- javë para fillimit të vitit shkollor).

Model se si mund tu shkruhet një letër e parë kontakti prindërve. (Prindërit kontaktohen nëpërmjet e-mailit, postës, ose caktohen oraret dhe ditët e pritjes së prindërve në ambientin e shkollës).

Të dashur prindër,

Për pak ditë ne po përgatitemi të fillojmë vitin e ri shkollor. Ekipi i shkollës “YYYY” është duke përgatitur një vit shkollor të mbushur me aktivitete shkollore, sportive, kulturore dhe sociale. Duke mësuar nëpërmjet lojës dhe aktiviteteve nxënësit tanë bëhen më të suksesshëm, dhe shkolla bëhet një ambient i dashur për ta.

Misioni i shkollës sonë për këtë vit është krijimi i një klime pozitive i cili do të ndihmojë çdo nxënës të ndihet i mirëseardhur në shkollë dhe ti ndihmojmë atë në arritjen e rezultateve shkollore.

Për ne është e rëndësishme që nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm, të rrisim cilësinë e shkollës tonë. Për ne është e rëndësishme që ju të vendosni së bashku me mësuesit aktivitetet që i përgjigjen më së miri nevojave të fëmijës tuaj. Duam që shkolla jonë të jetë një model i bashkëjetesës pa dallim race, gjinie, feje apo të mënyrave të jetesës.

TË GJITHË SË BASHKU MUND TË PERBALLOJMË MË MIRË TË GJITHA SFIDAT QË NA DALIN GJATË VITIT SHKOLLOR.

Transporti shkollor

Në këtë pjesë u shpjegohet prindërve dhe komunitetit se si fëmijët vijnë në shkollë dhe kthehen në shtëpi.

Kush janë përgjegjësit që merren me transportin.

Numrat e kontaktit në rast se fëmija mungon në shkollë dhe nuk do duhet ta marrin në shtëpi.



Organizimi i aktiviteteve pas orarit mësimor

Për të lehtësuar punën e organizimit të aktiviteteve është e rëndësishme që secili nga prindërit të shënoj paraprakisht në programin e shkollës se për cilat kurse/veprimtari do të dëshironte të regjistronte fëmijën e tij në shkollë, por gjithashtu dhe për cilat kurse/veprimtari ai do të ishte i gatshëm të ofrohej në mënyrë vullnetare pranë shkollës. Në këtë mënyrë ne jemi të sigurt se janë marrë parasysh nevojat e nxënësve, dhe jo vetëm shkolla ndihmon për realizimin e tyre por dhe prindërit gjithashtu. Në këmbim shkolla mund të ofrojë orë të hapura mësimore për prindërit që kanë dëshirë ti ndjekin, dhe në rastet kur janë mundësitë mund të ofroj kurse profesionale(mësimi i kompjuterit, ...) për prindërit në nevojë.

Tabela 1: Organizimi i veprimtarive nga shkolla dhe kërkesa ndaj komunitetit

Aktivitetet që ofron shkolla	Datat	Oraret	Mbështeten nga shkolla	Kërkojmë mbështetje nga komuniteti ¹

Tabela 2: Planifikimi i veprimtarive nga shkolla dhe komuniteti

Emri Mbiemri i	Aktiviteti	Datat	Oraret	Emri	Aktiviteti për të	Datat dhe
----------------	------------	-------	--------	------	-------------------	-----------

¹ Në dispozita është e rëndësishme të vendoset se sa % duhet të aktivizohet në mënyrë vullnetare secili nga prindërit në shkollë.

nxënësit	që do të ndjek				Mbiemri i Prindit	cilin ofron mbështetje në mënyrë vullnetare	oraret që propozohet aktivitetit

Na ndihmoni për të qenë më pranë jush në këtë vit shkollor

Do të dëshironim të na ndihmonit në këtë vit shkollor. Ju lutem vendosni një kryq në aktivitetet që ju mund të organizoni pranë shkollës sonë. Ju lutem ta plotësoni këtë fletë deri në fillim të viti shkollor.

Emri i shkollës: _____

Emri i prindërit: _____

Emri i fëmijës ose fëmijëve: _____

Ndihmon në klasë

Shoqëron nxënësit gjatë ekskursioneve

Ndihmon në organizimin e aktiviteteve artistike

Lexon libra për nxënësit gjatë aktiviteteve pas shkollore

Ndihmon, në mbikëqyrjen e nxënësve gjatë kohës së realizimit të detyrave në shkollë, ose mbikëqyrjen e fëmijëve gjatë organizimit të aktiviteteve socio-kulturore pas orarit mësimor

Aktivitete të tjera: shkruani ato aktivitete që ju mund të ofroni në ndihmë të shkollës.

shkollës

Për një organizim sa më të mirë të shkollës, gjatë kohës që ajo ofron aktivitete të shumta për nxënësit duhet që prindërit të njoftohen që në fillim të vitit shkollor. Gjithashtu është e preferueshme që dhe një kalendar të jetë i dukshëm në këndin e çdo klase. Në këtë kalendar paraprakisht vendosen të gjitha datat e muajit, dhe emrat e nxënësve që ndjekin aktivitete. Po gjithashtu nëse mësuesit e shohin të nevojshme të organizojnë intervista me prindërit duhet që datat dhe emri i nxënësit me të cilin do të organizohen takimet të vendoset në kalendar.

Në vijim ju paraqesim një shembull kalendari i cili plotësohet nga mësuesit kujdestar të çdo klase, dhe në rastet ku mësues të lëndëve të veçanta organizojnë takime me disa nxënës, vetë mësuesi i lëndës shënon emrat e nxënësve që do të marrin pjesë.


Duke pasur parasysh transparencën e organizimit të aktiviteteve në shkollë, ne krijojmë një ambient më të dashur brenda saj por dhe më të besueshëm për prindërit dhe komunitetin.

**Klasa e 8a “Emri i shkollës”
Motoja e nxënësve në këtë muaj**

MUAJI (SHTATOR)						
E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIELË
<i>1 aktiviteti Emri i nxënësit</i>	2 Takim me prindër	3	4	5 <i>Festa e Bajramit</i>	6 <i>Punë vullnetare: ose mësimi i rregullave të qarkullimit në terren.</i>	7
8	9	10 <i>aktiviteti Emri i nxënësit</i>	11	12	13	14
15	16	17	18 <i>aktiviteti Emri i nxënësit</i>	19	20	21
22	23 <i>aktiviteti Emri i nxënësit</i>	24	25 <i>Ekskursion Personi përgjegjës</i>	26 <i>aktiviteti Emri i nxënësit</i>	27	28
29	30					

Organizimi i bibliotekës në ambientet e shkollës
Të mësojmë më lehtë nëpërmjet leximit në çdo kohë

Të gjithë nxënësit pajisen me një kartë për të pasur mundësinë të zgjedhin libra në bibliotekë. Librat në bibliotekë mund të mblidhen nga burime të ndryshme: komuniteti, organizatat jo fitimprurëse, buxheti i shkollës, shtypshkronjat. Mënyra e menaxhimit të bibliotekës zgjidhet nëpërmjet bashkëpunimit të drejtorit të shkollës me bordin drejtues të shkollës. Mund të



ketë prindër që janë vullnetarë për të shërbyer si administratorë të bibliotekës, në orë dhe ditë të caktuara.

Organizimi i aktivitete për nxënësit me nevoja të veçanta

Shërbimi i ofruar	Personat përgjegjës	Shkolla/klasa	Shpjegimi i shërbimit
Fëmijët me vështirësi në të nxënë	Emri i personit përgjegjës	Emri i shkollës ose nr i klasës	Në këtë kurs ftohen të marrin pjesë të gjithë nxënësit që paraqesin vështirësi në të kuptuarin e objektivave mësimore.

Plan i organizimit për fillim vitin shkollor

Shërbimi	Qëllimi	Personat përgjegjës	Afatet	Komente/shënime/sygjerime
1. Organizimi i një seance informuese	- Analizimi i nevojave të nxënësve - Përzgjedhja e kurseve që ka nevojë nxënësi -njohja me formularët e rinj të fillim vitit		shtator	Personi që merret me organizimin e këtyre takime preferohet të jetë mësuesi kujdestar i klasës

Nxënësi në qendër të vendimeve tona

Nëse fëmijët vijnë për herë të parë në shkollën tonë: është e rëndësishme që të njihemi shumë mirë në lidhje me problemet që ata kanë.

Ne kemi dëshirë ti kushtojmë vëmendje të veçantë çdo fëmije që paraqet vështirësi të nivele të ndryshme po në veçanti fëmijëve që mund të kenë probleme të spektrit autik.

Për këtë para fillimit të vitit shkollor duhet ti kushtohet rëndësi e veçantë krijimit të planit të individualizuar të nxënësit, duke bashkëpunuar në mënyrë të vazhduar me prindërit dhe psikologun e shkollës.

Pika të rëndësishme që duhet të merren parasysh nga mësuesi për ti ofruar nxënësit me vështirësi të spektrit autik mbështetje sa më të efektshme:

- 🚩 Të njihen arsyet që rrisin ankthin te këta nxënës dhe strategjitë për ti qetësuar.
- 🚩 Të përzgjidhet një klasë që do të shërbejë si një vend i sigurt në rast se nxënësi ka nevojë të dalë nga klasa ku ndodhet (mund të jetë zyra e nëndrejtorit, ose salla e mësuesve).

- ✚ Planifikim i duhur i orareve.
- ✚ Të parashikohen pushime të rregullta.
- ✚ Zhvillimi dhe hartimi i një plani me të gjithë personat përgjegjës që ndihmojnë në zhvillimin e nxënësve me vështirësi në spektrin autik.
- ✚ Mësuesit duhet të sensibilizohen rreth autizmit (përfshirë drejtorin e shkollës, nëndrejtorin, stafi i bibliotekës, stafi mbështetës, dhe personel që është prezent në shkollë për realizimin e kurseve të SHQK).

Orientimi i nxënësve:

- ✚ Është e rëndësishme që çdo fëmijë të dijë vendin që do të qëndroj gjatë orarit të kurseve të ofruara pas mësimit, klasën, katin ku ndodhet klasa.
- ✚ Nxënësit orientohen, në lidhje me çdo aktivitet, nëpërmjet shigjetave orientuese.
- ✚ Disa mjete të posaçme për nxënësit që kanë vështirësi të spektrit autik.

Për të realizuar me sukses të gjitha udhëzimet e dhëna është shumë e rëndësishme që i gjithë stafi pedagogjik të jetë i mirë orientuar si edhe të ketë njohuritë e nevojshme për realizimin me sukses të aktiviteteve.

SHTOJCË

I. Standardet e shkollës si qendër komunitare

I.1 Ç'janë standardet e shkollës si qendër komunitare

Standardet e shkollës si qendër komunitare janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj si vendi ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi, të shprehura nëpërmjet treguesve përkatës, për të cilat është siguruar një miratim dhe rënie dakord në shkallë të gjerë nga komuniteti edukativ dhe nga institucionet shtetërore.

Standardet paraqiten të ndara në disa grupime (fusha) dhe shprehen nëpërmjet treguesve të detajuar, që, nga ana e tyre, provojnë përmbushjen e standardeve nga shkolla. Standardet e paraqitura janë standarde bazë, në kuptimin që ato duhet t'i përmbushë secila shkollë për tu quajtur si shkollë komunitare.

I.2 Pse nevojiten standardet e shkollës si qendër komunitare

Qëllimi kryesor i hartimit të këtyre standardeve është të ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe në tërë procesin e edukimit të nxënësve nëpërmjet partneritetit shkollë-familje-komunitet.

- Standardet përshkruajnë karakteristikat themelore të një shkolle si qendër komunitare në mënyrën më të përmbledhur dhe më të përdorshme, sesa të gjithë dokumentet e tjera, ndaj krijojnë lehtësi për shkolla dhe menaxhuesit e tyre.
- Standardet përbëjnë një marrëveshje të pranuar nga të gjithë dhe, si të tilla, janë më të besueshme se përshtypjet dhe konsideratat qofshin individuale apo në grup. Gjithashtu, standardet shërbejnë si argumente për shumë programe të zhvillimit që shkojnë në dobi të zhvillimit të shkollës.
- Standardet vijnë si rezultat i kërkimeve dhe i përvojave shumëvjeçare, ndaj dhe janë me më shumë vlera sesa punimet individuale brenda fushës së arsimit.
- Shkolla, duke u mbështetur te standardet, mund të bëjë vetë një vlerësim të punës së saj, për të konfirmuar nivelin ku ndodhet dhe përmirësimet që duhet të bëjë.

Përdoruesi i parë dhe më kryesor i standardeve është **shkolla**.

Standardet i vijnë në ndihmë shkollës:

- Të ndërmarrë veprimtari për identifikimin e nevojave dhe përcaktimin e prioriteteve, për të mbështetur të nxënit e nxënësve dhe përmirësuar arritjet e tyre.
- Të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta, të cilat sigurojnë informacionin e nevojshëm për planifikimet strategjike.
- Të përcaktojë fokusin e punës me partnerët dhe aktorët e tjerë.
- Të sigurojë feedback të vazhdueshëm nga nxënësit dhe familjet për të ndërtuar marrëdhënie të fuqishme me ta.
- Të vlerësojë dhe rishikojë cilësinë e marrëdhënieve me komunitetin.

I.3 Fushat e standardeve

1. Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës
2. Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve
3. Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit
4. Vendimmarrja e përbashkët
5. Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit

I.4 Standardet e shkollës si qendër komunitare

FUSHA : SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR PËR ÇDO NXËNËS

Shkolla, familja dhe komuniteti bashkëpunojnë për të mbështetur, pasuruar dhe nxitur të nxënit e fëmijëve dhe të rinjve, përmes veprimtarive formale dhe joformale, brenda dhe jashtë shkolle. Shkolla integron programe dhe shërbime që mbështesin zhvillimin akademik të nxënësve dhe plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre.

Standardi 1: Përmbyllja e nevojave dhe interesave të nxënësve

Treguesit:

- Shkolla nxit veprimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve për çështje që lidhen me suksesin e tyre në shkollë e jashtë saj.
- Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollë.
- Prindërit bashkëpunojnë me stafin e shkollës për të njohur stilet e të nxënit të nxënësve.

- Shkolla, në bashkëpunim me prindërit identifikojnë treguesit kryesorë që masin progresin e nxënësve.
- Shkolla angazhon mësues, prindër dhe partnerë të komunitetit për zhvillimin e programeve që mbështesin dhe pasurojnë zhvillimin akademik dhe joakademik të nxënësve.
- Shkolla siguron zhvillimin e rrugëve të komunikimit prindër-mësues për plotësimin e nevojave akademike dhe individuale të nxënësve.
- Shkolla bashkëpunon me prindërit për të siguruar që të gjithë nxënësit të kenë akses të barabartë ndaj programeve të përforsimit, të këshillimit, dhe llojeve të tjera të mbështetjes që përmirësojnë të nxënësit e tyre.
- Shkolla zhvillon veprimtari me nxënësit, prindërit dhe partnerë të komunitetit për çështje të tilla, si kurrikula e individualizuar, kurrikula në bazë shkolle, planifikimi i karrierës, etj.
- Shkolla zhvillon programe të veçanta për nxënësit e talentuar dhe nxënësit me vështirësi në të nxënë.

Standardi 2: Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së shkollës

Treguesit:

- Shkolla siguron dokumentimin dhe raportimin e veprimtarive, proceseve dhe rezultateve të arritjeve të nxënësve dhe shkollës në përgjithësi përmes kartës së performancës së shkollës.
- Komuniteti i shkollës analizon të dhënat dhe rishikon rezultatet për zhvillimin e strategjive që ndikojnë në përmirësimin e tyre.
- Prindërit informohen nga shkolla në mënyrë të vazhdueshme rreth arritjeve të nxënësve.

Standardi 3: Cilësia e mësimdhënies

Treguesit:

- Mësuesit përdorin strategji të ndryshme të mësimdhënies që nxisin suksesin e nxënësve.
- Mësuesit bashkëpunojnë me drejtuesit, prindërit, dhe anëtarë të tjerë të komunitetit për të krijuar një mjedis të hapur mësimdhënieje.
- Mësuesit përdorin metodologjitë ndërvepruese me nxënësit në qendër të cilat nxisin kuriozitetin dhe interesat e nxënësve.
- Mësuesit, në bashkëpunim me prindërit ndihmojnë nxënësit të ndjekin stile të ndryshme të të nxënësit për të patur sukses.
- Mësuesit nxitin motivimin e brendshëm të nxënësit, që ai të marrë përgjegjësi për të nxënësit e tij.
- Drejtuesit e shkollave angazhojnë prindërit dhe partnerë të komunitetit për planifikimin e veprimtarive që përmbushin nevojat dhe interesat e nxënësve.

- Stafi i shkollës ndjek trajnime dhe programe që mundësojnë zhvillimin profesional të tyre, me synim përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

FUSHA: SIGURIMI I MIRËQENIES SOCIALE, EMOCIONALE DHE SHËNDËTËSORE TË NXËNËSVE

Shkolla, bashkëpunon me prindërit dhe partnerë të tjerë të komunitetit për të njohur, adresuar dhe përmbushur nevojat fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Ato, së bashku, ofrojnë programe (që përfshijnë veprimtari fizike, e sportive, programe për të ushqyerin e shëndetshëm, veprimtari kulturore etj.) të cilat kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të klimës në shkollë.

Standardi 1: Mbështetja e zhvillimit social, emocional dhe shëndetësor të nxënësve

Treguesit:

- Të gjithë partnerët në shkollë bashkëpunojnë për zhvillimin e përvojave që ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë në zhvillimin e konceptit për veten, në ndërtimin e marrëdhënieve personale dhe ndërpersonale.
- Të gjithë partnerët në shkollë bashkëpunojnë për zhvillimin e përvojave që ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë në zhvillimin e stileve të jetës së shëndetshme.
- Shkolla në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, siguron zhvillimin e veprimtarive artistike, kulturore dhe sportive që përmbushin nevojat dhe interesat e nxënësve brenda dhe jashtë procesit mësimor.
- Shkolla planifikon një sërë shërbimesh që i adresohen parandalimit, ndërhyrjeve dhe trajtimit të nevojave, të bazuara në fokus grupet.
- Bordi i shkollës vlerëson treguesit e shëndetit mendor dhe fizik për të përcaktuar programet e shëndetit mendor dhe fizik të cilat duhet të jenë në fokus.
- Bordi i shkollës vlerëson burimet e vlefshme në komunitet që lidhen me shëndetin dhe përcakton rrugët për përdorimin e tyre për përmbushjen e nevojave të nxënësve.
- Shkolla bashkëpunon me shërbimet shëndetësore për të organizuar kontrolle të rregullta nga punonjës shëndetësorë për kujdesin oral, shëndetin e përgjithshëm etj.
- Shkolla angazhon mësues, prindër dhe partnerë të komunitetit për takime, konsultime e diskutime në lidhje me çështjet e shëndetit.

Standardi 2: Mbrojtja dhe mekanizmat e referimit

Treguesit:

- Shkolla, në bashkëpunim me organizmat e saj (qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve, bordi i shkollës) zhvillon programe për informimin e prindërve, anëtarë të tjerë të komunitetit për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve dhe respektimin e këtyre të drejtave.

- Të gjithë partnerët në shkollë sensibilizojnë fëmijët dhe të rinjtë për respektimin e të drejtave të tyre dhe adresimin e rasteve të shkeljes apo dhunimit të tyre.
- Shkolla bashkëpunon me prindërit dhe partnerë të tjerë për hartimin dhe zbatimin e politikave që mbështesin disiplinën pozitive në shkollë.
- Shkolla zhvillon trajnime me grupe të ndryshëm të interesit (mësues, prindër, nxënës, etj) për strategji dhe ndërhyrje për të parandaluar dhe trajtuar raste të dhunës, të konflikteve, të ngacmimeve dhe abuzimeve.
- Shkolla zhvillon mekanizma për raportimin e incidenteve të ndryshme.
- Ajo bashkëpunon me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe organizata që punojnë në këtë drejtim për adresimin dhe trajtimin e rasteve të ndryshme.
- Shkolla siguron mbikëqyrje nga të rriturit gjatë periudhave të pushimit apo gjatë zhvillimit të veprimtarive brenda dhe pas orarit shkollor.
- Psikologu i shkollës ofron këshillim për fëmijët, prindërit dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit për raste shqetësuese dhe problematika të ndryshme të jetës në shkollë e jashtë saj.
- Psikologu i shkollës, në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit, harton programe që adresojnë nevojave të veçanta të nxënësve.

Standardi 3: Mjedis fizik i shkollës

Treguesit:

- Shkolla ofron mjedise të sigurta të nxëni, të cilat garantojnë mirëqënien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve.
- Shkolla, me ndihmën e prindërve dhe kontributorëve të tjerë të komunitetit, siguron mjedise të shëndetshme me kushte higjeno-sanitare, kuti të ndihmës së shpejtë etj.
- Hapësirat fizike në shkollë u shërbejnë grupmoshave të ndryshme dhe nxënësve me nevoja të veçanta.
- Shkolla ofron hapësira të cilat mundësojnë zhvillimin e veprimtarive sportive, kulturore dhe artistike.
- Sigurimi i një mjedisi të gjelbëruar në shkollë dhe përreth saj.

FUSHA : ANGAZHIM DHE ZHVILLIM I KOMUNITETIT.

Shkolla ofron shërbime që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit, dhe komuniteti është pjesë përbërëse e aktiviteteve që organizon shkollë. Në këtë mënyrë nuk përfton vetëm komuniteti nga shkolla por dhe shkolla bashkëpunon me komunitetin për rritjen dhe përmirësimin e rezultateve për nxënësit. Prania e prindërve në shkollë dhe njohja me nevojat e nxënësve do të thotë më pak stres për familjarët dhe rezultate më të larta për nxënësit.

Standardi 1: Prania e prindërve në shkollë

Treguesit:

- Prindërit janë pjesë e zhvillimit të jetës së nxënësve në shkollë.
- Prindërit marrin iniciativa për zhvillimin e orëve të hapura mësimore.
- Komuniteti jep ide për planet që ndikojnë në rritjen e performancës së nxënësve.
- Ata marrin pjesë nëpërmjet punëve vullnetare në shkollë, ose në raste të veçanta mundësojnë fonde për zhvillimin e shkollës.
- Prindërit mund të mblidhen në shkollë nëse kanë nevojë për të diskutuar për të përmirësuar kushtet e shkollës apo për të përmirësuar marrëdhëniet mësues-nxënës-prindër.
- Prindërit ofrojnë shërbime në fushat që ata njohin ose punojnë: mjekësi, sport, arte etj..
- Prindërit janë të gatshëm të ndihmojnë në raste të problemeve dhe vështirësive të veçanta të çdo nxënësi.
- Prindërit bashkëpunojnë me shkollën për të hartuar një program formal për vullnetarizmin.

Standardi 2: Shkolla ofron zhvillim për komunitetin**Treguesit:**

- Shkolla ofron kurse që e ndihmojnë komunitetin të jetë i fortë dhe të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme.
- Shkolla ofron shërbime sociale, juridike, ligjore në rast nevojë të komunitetit.
- Shkolla përgatit komunitetin për strategjitë e ndërhyrjeve në rastin e emergjencave natyrore.
- Shkolla ndërgjegjëson komunitetin për rëndësinë e respektimit të diversitetit.
- Shkolla organizon aktivitete që kanë si qëllim forcimin e marrëdhënieve: komunitet-nxënës-mësues.
- Shkolla vendos në shërbim të komunitetit pajisjet e TIK-ut.
- Shkolla mundëson siguri të lartë të ambientit shkollor gjatë kohës së fluksit.
- Shkolla në bashkëpunim edhe me sektorët e shëndetit publik ofron kurse për këshillim familjar.
- Shkolla bashkëpunon me organizatat jo fitimprurëse për të ofruar kurse që i vijnë në ndihmë zhvillimit të kompetencave kyçe të komunitetit (kurse leximi dhe shkrimi, kurse profesionale, etj...).
- Shkolla ka një program ku secili prind mund të ofroj diçka në mënyrë vullnetare për realizimin e aktiviteteve.

Standardi 3: Krijimi i kushteve që mundësojnë zhvillim të përbashkët**Treguesit:**

- Shkolla merr masa për ndarjen e detyrave për menaxhimin e aktiviteteve që ndodhin në shkollën si qendër komunitare.
- Shkolla merr masa për vlerësimi dhe monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i situatës për të parë funksionimin, rezultatet dhe impaktin e aktiviteteve.
- Aktivitet hartohen duke u bazuar në objektiva të matshëm dhe të realizueshëm nga ekipi i shkollës dhe komuniteti.
- Shkolla ofron zhvillim të vazhdueshëm profesional për personelin e saj.
- Shkolla ofron një numër të caktuar aktiviteteve që i përgjigjen nevojave më të përgjithshme të nxënësve dhe komunitetit.
- Biblioteka e shkollës është e hapur ndaj komunitetit, dhe ofron literaturë në shërbim të tij.
- Shoqata dhe organizata jo fitimprurëse ndihmojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për kthimin e shkollës si qendër komunitare.
- Shkolla realizon vendosjen e një zyre për këshillim psikologjik dhe social në shkollë.
- Shkolla u jep informacionin prindërve në gjuhën e tyre, dhe secili prind ndihet i lirshëm të flasë në gjuhën e tij.

Standardi 4: Financimi i kurse që ofrohen për komunitetin dhe nga komuniteti

Treguesit:

- Shkolla bashkëpunon me prindërit për të gjetur mënyra financimi për kurset jashtë shkollore.
- Shkolla bashkëpunon me prindërit për të ofruar kurse jashtë kurrikulare pa kosto.
- Shkolla bashkëpunon me agjencitë/organizatat/bizneset për tu mundësuar pjesëmarrësve të komuniteti dhe nxënësve kurse sipas nevojave
- Shkolla ka krijuar mekanizma për një komunikim të vazhdueshëm me agjencitë/organizatat/bizneset për të pasur një koordinim të suksesshëm.
- Shkolla mbështet talentet e reja.

Standardi 5: Prindërit janë të përfshirë në planifikimin, menaxhimin, vlerësimin implementimin dhe aprovimin e programit në oraret jashtë shkollore.

Treguesit:

- Ekzistojnë mënyra që ndikojnë në përfshirjen e prindërve për të dhënë mendime rreth politikës së shkollës, kurrikulës së aktiviteteve shkollore dhe procedurave për mbarëvajtjen e nxënësve.
- Ekzistojnë shumë mundësi për të komunikuar me prindërit në çdo kohë.
- Prindërit dhe komuniteti ndjehen të mirëseardhur dhe të respektuar në shkollë.
- Pritshmëritë për pjesëmarrjen e prindërve në aktiviteteve janë të formuluar qartë dhe u janë komunikuar prindërve.

FUSHA: VENDIMMARRJA E PËRBASHKËT

Prindërit, komuniteti dhe stafi i shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në vendimmarrjet që ndikojnë në cilësinë e shkollës dhe arritjet e nxënësve. Ata së bashku mund të informojnë, ndikojnë dhe krijojnë politika, praktika dhe programe në dobi të suksesit të nxënësve.

Standardi 1: Planifikimi strategjik i institucionit arsimor

Treguesit:

- Shkolla angazhon edhe prindërit dhe komunitetin në hartimin e planit strategjik afatmesëm dhe planin vjetor të institucionit.
- Vizioni i shkollës përcaktohet bashkë me komunitetin e shkollës. Ai përmbledh aspiratën dhe besimin e anëtarëve të komunitetit.
- Vizioni dhe qëllimet e vëna në planin afatmesëm dhe atë vjetor marrin parasysh nevojat e gjithë komunitetit.
- Planifikimi strategjik vlerësohet vazhdimisht nga institucioni në bashkëpunim me komunitetin.
- Planet e shkollës bëhen publik në çdo kohë për të gjithë përfaqësuesit e komunitetit që janë të interesuar.

Standardi 2: Drejtimi i institucionit arsimor

Treguesit:

- Drejtuesit e shkollës inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrësit e komunitetit në përfshirjen në vendimmarrje dhe veprimtari të shkollës.
- Drejtuesit kanë një plan të përfshirjes së prindërve dhe komunitetit në veprimtarinë e shkollës.
- Drejtuesit kanë evidencë të nismave të reja dhe inovative të dala nga nxënësit dhe komuniteti.
- Drejtuesit monitorojnë që angazhimi i komunitetit përmbush standardet e vëna.
- Drejtuesit dokumentojnë angazhimin e prindërve dhe komunitetit në vendimmarrje.
- Drejtuesit aplikojnë procedura të qarta për të mundësuar përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.
- Drejtuesit aplikojnë procedura për të zbuluar mundësitë e komunitetit për të ofruar ndihmë për shkollën.
- Drejtuesit organizojnë shpërndarjen e informacionit në dispozicion të anëtarëve të komunitetit me të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e shërbimit të institucionit arsimor.

Standardi 3: Organizmat e institucionit arsimor

Treguesit:

- Shkolla krijon mundësinë që në bordin e institucionit, këshillin e prindërve dhe organizma të tjerë, ku ka përfaqësues të komunitetit, të zgjidhen përfaqësues nga nivele të ndryshme social-ekonomike të komunitetit.
- Shkolla organizon diskutimin e planeve strategjike me këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve, me bordin e institucionit, me qeverinë e nxënësve dhe me përfaqësues të tjerë të komunitetit të shkollës.
- Bordi i institucionit miraton planin e afatmesëm dhe vjetor të institucionit.
- Bordi i institucionit miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet të cilat sigurohen nga institucioni.
- Bordi i institucionit dhe këshilli i prindërve të institucionit angazhohen në hartimin dhe shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit arsimor.
- Bordi i institucionit, këshilli i prindërve dhe qeveria e nxënësve bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të institucionit arsimor.
- Bordi i institucionit, këshilli i prindërve dhe përfaqësues të njësisë bazë të qeverisjes vendore angazhohen në procesin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit dhe mësuesve.
- Bordi i institucionit, këshilli i prindërve dhe përfaqësues të njësisë bazë të qeverisjes vendore informohen dhe trajnohen për përfshirjen efektive në procesin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit dhe mësuesve.

Standardi 4: Zëri komunitetit në vendimmarrjen e përbashkët**Treguesit:**

- Shkolla zbaton politikat e vendosura për të siguruar që gjithë prindërit dhe familjarët të kenë një zë të barabartë me vendimmarrjet kryesore që ndikojnë tek nxënësit.
- Shkolla siguron dialog me familjet dhe komunitetin për të mbledhur idetë dhe sugjerimet e tyre.
- Shkolla informon familjet dhe komunitetin për çështjet që duhen ndryshuar dhe i jep mundësi të reagojnë.
- Prindërit dhe komuniteti trajnohen për të zotëruar aftësi të menaxhimit dhe diskutimit të ideve për përmirësimin e cilësisë së shkollës.
- Shkolla ndihmon prindërit dhe komunitetin të njohin politikën e menaxhimit të institucionit që ndikon në zhvillimin dhe arritjet e nxënësve.
- Prindërit dhe komuniteti iniciojnë dhe organizojnë fushatat sensibilizuese në dobi të veprimtarive që ndërmerr shkolla.
- Prindërit dhe familjet advokojnë për të mobilizuar të gjithë aktorët për të mbështetur veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin dhe arritjet e nxënësve.
- Prindërit dhe drejtuesit e shkollës organizojnë takime me aktorët lokalë për të diskutuar ide dhe probleme të shkollës dhe komunitetit.

FUSHA : GJITHËPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT

Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvarur.

Standardi 1: Respektimi i të drejtave të fëmijëve

Treguesit:

- Shkolla ka materiale informuese për të drejtat e fëmijëve.
- Të drejtat e fëmijëve mësohen në çdo nivel shkollimi.
- Ekzistojnë klube shkollore me aktivitete jashtëshkollore ku kanë mundësinë të përfshihen të gjithë fëmijët.
- Mendimet e fëmijëve dëgjohen dhe merren parasysh.
- Shkolla krijon një klimë pozitive për zgjidhjen e konflikteve.
- Shkolla krijon dhe përmirëson mekanizmat që sigurojnë se të gjithë fëmijët trajtohen në mënyrë të drejtë, të barabartë, me dinjitet dhe respekt.
- Shkolla ka rregulla të sjelljes në shkollë, të cilat nuk diskriminojnë fëmijët dhe nuk lejojnë diskriminimin e tyre.
- Personeli arsimor (drejtuesi, mësuesi, psikologu, sociologu) në shkollë janë trajnuar të respektojnë dallimet e cilësdo natyrë dhe të reagojnë ndaj çfarëdo diskriminimi të nxënësve dhe personelit të shkollës dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në krijimin e perceptimeve të drejta të nxënësit.

Standardi 2: Mundësi të barabarta për t'u regjistruar në shkollë, për ta ndjekur dhe përfunduar atë.

Treguesit:

- Shkolla bashkëpunon me zyrën e regjistrimit civil dhe qendrën shëndetësore dhe merr prej tyre listën e të gjithë fëmijëve të moshës shkollore të zonës (sipas udhëzimeve/DN-ve në fuqi e marrëveshjes 4-ministore).
- Shkolla ka formuar komisionin në nivel shkolle për vlerësim dhe regjistrim të fëmijëve, siguron formularët për vlerësim dhe regjistrim të fëmijëve në shkollë dhe i përmbahet asaj.
- Shkolla ka përgatitur bazën e të dhënave me evidenca të nxënësve të regjistruar dhe të dhëna të tjera për nxënësit dhe shkollën.
- Shkolla ka ekipin funksional për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.
- Shkolla ka marrëveshje të bashkëpunimit dhe bashkëpunon me organizata dhe institucione që ndihmojnë sigurimin e gjithëpërfshirjes në shkollë.

- Shkolla merr masa për trajnimin e stafit për problemet e gjithëpërfshirjes dhe respektimit të diversitetit.
- Shkolla ka procedura për identifikimin dhe analizën e shkaqeve për përsëritjen e vitit shkollor dhe ndërmerr masa me kohë për zvogëlimin e numrit të nxënësve që përsërisin klasën.
- Mësuesit dhe nxënësit identifikojnë nxënësit e rrezikuar për largim nga mësimi dhe shkolla për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm.
- Shkolla informon nxënësit për mundësitë e shkollimit të mëtejshëm, edukimin në karrierë, etj.

Standardi 3: Përshtatja me nevojat e zhvillimit të fëmijës

Treguesit:

- Mjedisi i shkollës dhe hapësirat fizike u shërbejnë fëmijëve të grupmoshave të ndryshme.
- Veprimtaritë organizohen në mënyrë që t'i përshtaten fazave të zhvillimit të fëmijëve.

Standardi 4: Mjedisi pa pengesa

Treguesit:

- Shkolla siguron që mjetet mësimore janë të arritshme dhe të përdorshme nga të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë dhe nevojave të veçanta.
- Mjedisi nxit integrimin e të gjithë nxënësve pavarësisht nga grupi të cilit i përkasin (gjinia, aftësi e kufizuar, etnia, feja etj.) në të njëjtin mjedis të nxëni dhe mësimdhënieje.
- Gjatë planifikimit të mjedisit të shkollës janë bërë përshtatje të veçanta në mjedis për nxënësit me nevoja të veçanta.
- Të gjithë nxënësit, stafi dhe vizitorët kanë mundësi të përdorin mjetet sanitare.
- Mësuesit e përshtatin mjedisin e punës dhe aktivitetet e të mësuarit, në mënyrë që fëmijët me përkatësi të ndryshme kulturore, me nevoja të ndryshme në arsim dhe të niveleve të ndryshme shoqërore të jenë pjesëmarrës të barabartë.

Standardi 5: Infrastruktura e disponueshme për personat me aftësi të kufizuar

Treguesit:

- Të gjitha rrugët e kalimit dhe dyert kanë një minimum prej 90 cm gjerësi që të mundësojnë kalimin e një karroce të personit me aftësi të kufizuar fizike.
- Sipërfaqet e dyshemesë janë të forta, të qëndrueshme, të rezistueshme ndaj rrëshqitjes dhe të sheshta.
- Në shkollë ka rampa për personat me aftësi të kufizuara.
- Shkolla zotëron të paktën një karrige personi me aftësi të kufizuar.
- Shkolla ka tualete të përdorshme për personat me aftësi të kufizuara. Përdoruesit e karrigeve me rrota kanë mundësi të afrohen, të hyjnë, të lëvizin dhe të përdorin mjetet sanitare brenda ambienteve të shkollës.

- Klasat kanë hapësirë të mjaftueshme për të lejuar lëvizjen e nxënësve me aftësi të kufizuar.

Standardi 5: Infrastruktura duhet të jetë e disponueshme nga të dy gjinitë

Treguesit:

- Në shkollë ka tualete të veçanta për vajzat dhe për djemtë.
- Sigurimi i sheshit të lojërave krijon mundësi që si djemtë ashtu edhe vajzat të mund të marrin pjesë lirisht në sporte dhe lojëra.

Standardi 6: Qeverisja e shkollës

Treguesit:

- Programi shkollor paraqet strategji për të mundësuar pjesëmarrjen si të djemve ashtu edhe të vajzave në Qeverinë e Nxënësve gjithashtu dhe te burrave dhe të grave në Bordet e shkollave.
- Programi shkollor siguron strategji për të mundësuar pjesëmarrjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe te pakicave etnike në Qeverinë e Nxënësve.

Standardi 7: Veprimtaritë mësimore

Treguesit:

- Gjatë zbatimit të programit shkollor përdoren praktika, modele, veprimtari që sigurojnë përzierjen e grupeve pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike.
- Programi shkollor përmban njohuri dhe aftësi për të identifikuar dhe eleminuar paragjykimet në shkollë.
- Programi shkollor mundëson që nxënësit të shprehin pikëpamjet e tyre mbi politikat e shkollës për gjithëpërfshirjen dhe respektimin e diversitetit.
- Kurrikula ofron përmbajtje dhe modele të respektimit të kulturave, traditave, besimeve, gjuhëve të ndryshme etj.
- Mësuesit u ofrojnë nxënësve materiale didaktike që pasqyrojnë në mënyrë të drejtë diversitetet kulturore dhe rëndësinë e diversiteteve në shoqëri.

II. Udhëzimi i MAS për DAR/ZA dhe shkollat

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 1794/1 Prot.

Tiranë, më 31.03.2014

LËNDA: Letër sqaruese për funksionimin e shkollën si qendër komunitare

DREJTUAR: DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE

ZYRAVE ARSIMORE

Në mbështetje të zbatimit të standardeve "Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë", Nr 1794 prot, datë 13.03.2014, si dhe takimeve të organizuara me donatorët më 25 nëntor 2013 dhe 17 shkurt 2014 dhe me DAR/ZA-të më 20 shkurt 2014, Ju sqarojmë se fazat e mëtejshme të punës për ecurinë e nismës SHQK do të jenë:

Faza 1

Konsolidimi i nismës në secilën DAR/ZA

- Të jenë ngritur ekipet kordinuese në çdo DAR/ZA;
- Të jetë hartuar plani veprimeve për çdo DAR/ZA (sipas modelit bashkëlidhur);
- Të raportohet një herë në javë për ecurinë e SHQK tek kordinatori përkatës në MAS (lista bashkëlidhur);
- Të fillojë zbatimi në shkollat pilot pasi të jetë finalizuar përzgjedhja e shkollave (sipas listës bashkëlidhur);
- Të jenë dërguar dhe sqaruar standardet e SHQK në secilën shkollë pilot;
- Të ngrihet rrjeti i shkollave si qendra komunitare. Kjo nënkupton rrjetin e institucioneve në një DAR, shkolla me profile të ngjashme, të cilat shkëmbejnë përvojë dhe marrin pjesë në veprimtari të ndërsjella.

Konsolidimi i nismës në secilën shkollë pilot

Mbështetur në nismën “Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë” shkollat të parashikojnë veprimtari që të jenë të zbatueshme në përshtatje me profilin e saj, në bazë të nevojave të identifikuar dhe burimeve të vlefshme në shkollë apo komunitet, duke përmbushur këto objektiva:

- Të sigurojë hapjen e saj përtej orarit mësimor, duke realizuar aktivitete që mundësojnë rritjen e cilësisë në arsim;
- Shkolla të ofrojë shërbime që sigurojnë mirëqenie sociale, fizike, emocionale dhe shëndetësore për të gjithë;
- Të mundësojë angazhimin dhe zhvillimin socio-ekonomik të komunitetit si dhe shërbimeve mbështetëse ndaj familjarëve;
- Të jetë bashkëpunuese dhe inicuese duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të aktorëve në vendimmarrje;

Për të realizuar këto objektiva është e domosdoshme :

- Të jenë ngritur ekipet koordinuese në çdo shkollë pilot.
- Ekipi koordinues të përbëhet nga drejtori shkollës (ose një nëndrejtor), anëtarë i bordit të prindërve, nxënës nga qeveria e nxënësve, mësues të shkollës, përfaqësues i pushtetit vendor, përfaqësues të partnerëve të tjerë socialë që mbështesin këtë nismë. Drejtuesi i këtij ekipi të jetë drejtori i shkollës.
- Të jetë hartuar, nga ekipi koordinues, kalendari veprimeve për çdo shkollë pilot (sipas modelit bashkëlidhur).
- Të ketë në fokusin e saj respektimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirës (shiko pikën I.5 të standardeve)
- Të raportohet një herë në javë për ecurinë e SHQK tek koordinatori përkatës në DAR/ZA (lista bashkëlidhur)
- Të jenë familjarizuar me standardet e SHQK
- Të ngrihet këndi i shkollës qendër komunitare në të cilin të përfshihen rubrika si :
“Pse shkolla është pjese e qasjes “Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”; *“Kush e drejton këtë qasje në shkollë”;* *“Veprimtaritë që do realizojë shkolla, si dhe*

kalendari i zbatimit të tyre”(sipas modelit bashkëlidhur). “Aktorët që shkolla mendon të përfshijë në realizimin e kësaj qasjeje”.

Faza 2: Promovimi i nismës së shkollave si qendra komunitare në komunitet

- DAR/ZA dhe ekipet kordinuese në shkolla të ndërmarrin veprimtari për ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve mbi qasjen e shkollës si qendër komunitare përmes bisedave, tryezave, debateve të hapura, fletëpalosjeve, mediave lokale etj.
- Ekipet kordinuese në shkolla, në mbështetje të planit të kalendarit të veprimtarive të marrin masa për përmirësimin ose përshtatjen e infrastrukturës shkollore për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të parashikuara.
- DAR/ZA, ekipet koordinuese në shkolla dhe donatorët që mbështesin nismën në këto shkolla të shikojnë mundësitë për vënien në dispozicion të shkollave të materialeve të domosdoshme për të mundësuar veprimtari të ndryshme sipas tematikave passhkollore të përcaktuara në kalendar.

Faza 3 Bashkërendimi i veprimtarive me Institucionet e Arsimit të lartë dhe pushtetin vendor.

DAR/ZA të kordinojnë me pushtetin vendor për mbështetjen e nismës “Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”:

- a) Duke nënshkruar një marrëveshje të përbashkët për realizimin e saj.
- b) Duke i përfshirë në ekipet koordinuese.
- c) Duke marrë masa për mirëfunksionimin e shkollës përtej orarit mësimor.

DAR/ZA të bashkërendojnë veprimtaritë e “Shkolla si qendër komunitare”, me IAL:

- a) Duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave të studentëve (sipas profileve dhe ku është e mundur) në Shkollat si qendër komunitare.
- b) Duke përfshirë studentët në ekipet kordinuese për realizimin e aktiviteteve në SHQK mbi baza vullnetare.

Motivimi i studentëve, vijimësia e praktikës së tyre në SHQK, puna mbi baza vullnetare në këto shkolla, si dhe njohja e këtij bashkëpunimi do të rregullohet me nënshkrimin e marrëveshjes në nivele më të larta ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Faza 4. Bashkërendimi i veprimtarive me aktorë të tjerë në mbështetje të qasjes SHQK

- Mësuesit e shkollës, sipas profileve të tyre, mund të organizojnë veprimtari për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e nxënësve, si dhe për të zhvilluar prirjet e tyre në lëndë të ndryshme;
- Mësuesit që kanë në normën e tyre aktivitete sportive, artistike, bibliotekë etj., mund të planifikojnë veprimtari me nxënësit jashtë procesit mësimor;
- Mësues të shkollës me ngarkese jo të plotë mësimore mund të plotësojnë normën duke u aktivizuar në veprimtaritë e shkollës qendër komunitare;
- Psikologët, punonjësit socialë, mjekët, dentistët, të përcaktuar sipas shkollave mund të aktivizohen gjerësisht në realizimin e veprimtarive të kësaj nisme;
- Mësues pensionistë të cilët janë të gatshëm mund të ofrojnë mbështetjen e tyre;
- Prindër që sipas profesionit mund të angazhohen për veprimtari të ndryshme.

PLARENT NDRECA



SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



PLANI I VEPRITMARIVE PËR SHKOLLËN SI QENDËR KOMUNITARE

DAR/ZA _____

SHQK	Afati kohor														Koordinatori DAR/ZA	Koordinatori shkollës	Faktorët e Riskut dhe Suksesit	
Veprimtaria	AFATET KOHORE (Java/Muaji)																	
	Mars		Prill				Maj				Qershor							
Veprimtarite e DAR	3	45	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4				
1	Identifikimi i shkollave pilot																	
2																		
3																		
4																		
5																		
6																		
7																		



Kalendari I VEPRITMARIVE PËR SHKOLLËN SI QENDËR KOMUNITARE

SHQK	Afati kohor														Koordinatori	Koordinatori shkollës	Faktorët e Riskut dhe Suksesit
Veprimtaria	AFATET KOHORE (Java/Muaji)																
Veprimtarite e shkolles	<i>Mars</i>		<i>Prill</i>				<i>Maj</i>				<i>Qershor</i>						
	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4			
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	



QARKU (12)	RRETHI (36)	BASHKIA (64)	SHKOLLA/ INSTITUTI
QARKU TIRANE (Enida Kume)	RRETHI TIRANE	TIRANA	GJIMNAZI " PETRO NIN LUARASI", SHKOLLA 9-VJEÇARE " E KUQE"
		1.KASHAR 2. PETRELE	1. GJIMNAZI "SADIK STAVILECI" (E ka zgjedhur DAR) 2. GJIMNAZI "IBRAHIM HASMEMA" (E ka zgjedhur DAR)
		VORA	SHKOLLA 9-VJECARE MARQINET (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI KAVAJE	KAVAJE	
		RROGOZHINE	
QARKU DURRES (Altea Tahiraj)	RRETHI DURRES	DURRES	SHKOLLA E MESME E BASHKUAR "E RE" KENETE (WORLD VISION; DAR)
		DDURRES	SKOLLA9- VJECARE " EFTALI KOCI" (e ka zgjedhur UNICEF)
		MANZE	Shkolla e Mesme - MANXE (E ka zgjedhur DAR)
		SUKTH	Shkolla e Mesme - SUKTH (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI KRUJE	KRUJE	GJIMNAZI "SKENDERBEU" (JUNIOR ACHIEVEMENT;DAR)
		FUSHE-KRUJE	SHKOLLA E MESME "SHOTE GALICA" (E ka zgjedhur DAR)
	QARKU ELBASANIT (Altea Tahiraj)	RRETHI ELBASANIT	ELBASAN
CERRIK			GJIMNAZI "TOMORR SINANI" (JUNIOR ACHIEVEMENT; DAR)
BELSH			GJIMNAZI "SAMI FRASHERI" (E ka zgjedhur DAR)
RRETHI LIBRAZHIDIT		LIBRAZHID	E MESME E BASHKUAR "SHEFQET DOSKU" (E ka zgjedhur DAR)
		PRRENJAS	GJIMNAZI "HALIT BERZHITA" (Peace Corps;DAR)
RRETHI GRAMSHIT		GRAMSH	GJIMNAZI "SHEFQET GUZI" (Peace Corps; DAR)
RRETHI PEQINIT		PEQIN	SHKOLLA 9-VJECARE BISHQEM (E ka zgjedhur DAR)



QARKU	RRETHI	BASHKIA	SHKOLLA/ INSTITUTI
QARKU VLORE (Marjana Lako)	RRETHI VLORE (Meri Todhe)	VLORE	SHKOLLA 9 - VJECARE "MARIGO POSIO" (E ka zgjedhur DAR)
		ORIKUM	SHKOLLA 9-VJECARE "BALIL PELATI" (E ka zgjedhur DAR)
		HIMARE	GJIMNAZI "SPIRO GJIKNURI" (Peace Corps; DAR)
		SELENICE	SHKOLLA E MESME "HAJREDIN BEQARI" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI SARANDE	SARANDE (KSAMIL)	SHKOLLA E MESME E BASHKUAR "5 HERONJTE" (PEACE CORPS; DAR)
		KONISPOL	SHKOLLA E MESME E BASHKUAR "BIDO SEJKO" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI DELVINE	DELVINE	GJIMNAZI "SULEJMAN DELVINA" (Peace Corps; DAR)
QARKU SHKODER (Ilir Kanini)	RRETHI SHKODER	SHKODER	SHKOLLA 9-VJECARE "AZEM HAJDARI" (WORLD VISION; DAR)
		VAU DEJES	E MESME E BASHKUAR "VAU DEJES" (Peace Corps; DAR)
	RRETHI PUKE	PUKE	SHKOLLA 9-VJECARE "MIGJENI" (E ka zgjedhur DAR)
		FUSHE-ARREZ	9-VJECARE "PJETER ARBNORI" (Peace Corps; DAR)
	RRETHI MALESI E MADHE	KOPLIK	SHKOLLA 9-VJECARE "PREKE GJONI" (E ka zgjedhur DAR)
QARKU KORCE (Tatjana Vuçani)	RRETHI KORCE	KORCE	SHKOLLA E MESME "THEMISTOKLI GERMENJI" (E ka zgjedhur DAR)
		KORCE	SHKOLLA 9-VJEÇARE DEMORKACIA (E ka zgjedhur UNICEF)
	RRETHI KOLONJE	MALIQ	SHKOLLA 9-VJECARE "AGIMI" (SAVE THE CHILDREN, WORLD VISION,DAR)
		ERSEKE	SHKOLLA E MESME "PETRO NINI LUARASI" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI POGRADEC	POGRADEC	GJIMNAZI "MUHARREM COLLAKU" (Peace Corps; COUNCIL OF EUROPE;DAR)
	RRETHI DEVOLL	BILISHT	SHKOLLA 9-VJECARE BILISHT (E ka zgjedhur DAR)



QARKU	RRETHI	BASHKIA	SHKOLLA/ INSTITUTI
QARKU FIER (Shqiponja Lamçe)	RRETHI FIER	FIER	SHKOLLA 9-VJECARE "KRISTAQ SHTEMBARI" (E ka zgjedhur DAR)
		PATOS	SHKOLLA 9-VJECARE " HEKURAN MANEKU" (E ka zgjedhur DAR)
		ROSKOVEC	SHKOLLA 9-VJECARE "ALUSH GREPCKA" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI LUSHNJE	LUSHNJE	SHKOLLA E MESME "VATH KORESHI" (JUNIOR ACHIEVEMENT; DAR)
		DIVJAKE	SHKOLLA 9-VJECARE "KOCI SAKO" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI MALLAKASTER	BALLSH	SHKOLLA 9-VJECARE "BESELIDHJA" (E ka zgjedhur DAR)
QARKU BERAT (Shqiponja Lamçe)	RRETHI BERAT	BERAT	SHKOLLA 9-VJECARE "M.A VRIONI" (E ka zgjedhur DAR); SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHME "BABE DUDE KARBUNARA" (E ka zgjedhur DAR)
		URA-VAJGURORE	SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHME "MUHAMER JANINA" (JUNIOR ACHIEVEMENT;DAR)
	RRETHI SKRAPAR	COROVODE	SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHME "RAMIZ ARANITASI" (Peace Corps; DAR)
		POLICAN	
	RRETHI KUCOVE	KUCOVE	"GJIMNAZI KUCOVE" (Peace Corps; DAR)
QARKU LEZHE (Ilir Kanini)	RRETHI LEZHE	LEZHE	SHKOLLA 9-VJECARE "BESELIDHJA" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI KURBIN	LAC	SHKOLLA 9-VJECARE "NR 2" (WORLD VISION;DAR)
		MAMURRAS	GJIMNAZI MAMURRAS (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI MIRDITE	RRESHEN	GJIMNAZI RRESHEN (E ka zgjedhur DAR)
		RUBIK	SHKOLLA 9-VJECARE RUBIK (E ka zgjedhur DAR)




QARKU	RRETHI	BASHKIA	SHKOLLA/ INSTITUTI
QARKU KUKES (Besnik Rama)	RRETHI KUKES	KUKES	SHKOLLA 9-VJECARE "RIZA SPAHIU" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI TROPOJE	BAJRAM CURRI	SHKOLLA 9-VJECARE "ALI PODRIMJA" (COUNCIL OF EUROPE; DAR)
	RRETHI HAS	KRUMA	SHKOLLA E MESME "SKENDERBEU" (E ka zgjedhur DAR)
QARKU DIBER (Besnik Rama)	RRETHI DIBER	PESHKOPI	SHKOLLA 9-VJECARE "IRFAN HAJRULLAJ" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI MAT	BURREL	SHKOLLA 9-VJECARE "31 KORRIKU" (Save the Children; DAR)
	RRETHI BULQIZE	BULQIZE	SHKOLLA 9-VJECARE "SHEFQET TANJI" (E ka zgjedhur DAR)
QARKU GJIROKASTER (Marjana Late)	RRETHI GJIROKASTER	GJIROKASTER	SHKOLLA E MESME "ASIM ZENELI"(E ka zgjedhur DAR); SHKOLLA 9-VJECARE "KOTO HOXHI" (SAVE THE CHILDREN;DAR)
		LIBOHOVE	SHKOLLA E MESME "11 SHKURTI" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI TEPELENE	TEPELENE	SHKOLLA 9-VJECARE "7 MARSII" (E ka zgjedhur DAR)
		MEMALIAJ	SHKOLLA 9-VJECARE "MEMALIAJ" (E ka zgjedhur DAR)
	RRETHI PERMET	PERMET	SHKOLLA 9-VJECARE "MELEQ GOSTNISHTI" (E ka zgjedhur DAR)
		KELCYRE	SHKOLLA 9-VJECARE "KAMBER BENJA" (E ka zgjedhur DAR)



Tabela e koordinatorëve të MAS dhe DAR/ZA-ve për “Shkolla, qendër komunitare”, 2014

DAR/ZA	Koordinatori i MAS	Adresa kontakti me koordinatorin e MAS			Koordinatori i DAR/ZA	Adresa kontakti me koordinatorin e DAR/ZA		
		e-mail	celular	zyrë		e-mail	celular	zyrë
Berat	Shqiponja Lamçe	Shqiponja.Lamce@arsimi.gov.al	0696008862		Majlinda Xhamo	majlindachamo@yahoo.com	0682283658	
Skrapar					Albana Osmani	Albana.osmani@yahoo.com	0698674205	03122677
Kuçovë					Jonida Dinaj	jonidadinaj@gmail.com	0697235465	
Dibër	Besnik Rama	Besnik.Rama@arsimi.gov.al	0672665525	2232455	Brikena Dani	brikenadani@gmail.com	0684173757	
Mat					Shpresa Tusha	sh.tusha@live.com	0692273424	
Bulqizë					Kujtim Kerkuti	Enki.timi333@hotmail.com	0682334253	
Elbasan	Altea Tahiraj	Altea.Tahiraj@arsimi.gov.al	0693306977	2232455	Florenc Kushi	florenckushi@gmail.com	0674309400	
Gramsh					Xhevid Dermyshe	xheviddermyshe@hotmail.com	0682360835	
Peqin					Lulzime Kryemadhi	Lulzime18@yahoo.com	0695250720	0682886120
Librazhd					Qani Çela	qanicela@yahoo.com	0682731083	
Fier	Shqiponja Lamçe	Shqiponja.Lamce@arsimi.gov.al	0696008862		Mirela Emiri	m.emiri@yahoo.com	0696249931	
Lushnjë					Elda Sinjari	eldasinjari@gmail.com	0694332007	
Mallakastër					Nertila Vasku	nertilalamcaj@yahoo.com	0695569236	31322652
Gjirokastrë	Marjana Lako	Marjana.Lako@arsimi.gov.al	0672738231		Albana Hasanaj	hasanajalbana@gmail.com	0694444846	
Tepelenë					Luan Gjergjo	lgjergjo@yahoo.com	0692567730	
Përmet					Saliko Hodo	salikohodo@yahoo.com	0692475149	
Durrës	Altea Tahiraj	Altea.Tahiraj@arsimi.gov.al	0693306977	2232455	Anesti Shuke	anestishuka@gmail.com	0682207143	
Krujë					Saba Lama	saba.lama@yahoo.com	0696514794	
Tiranë Qytet	Enida Kume	enida.kume@arsimi.gov.al	0676019801		Mira Peshkatari	peshkatarimira@yahoo.com	0674020942	
Tiranë Qark	Enida Kume	enida.kume@arsimi.gov.al	0676019801		Frrok Kacorri	Frrok.Kacorri@darqt.edu.al	0682320899	
Kamëz						Frrok.Kacorri@darqt.edu.al		
Kavajë						Frrok.Kacorri@darqt.edu.al		
Lezhë	Ilir Kanini	Ilir.Kanini@arsimi.gov.al	0682417530		Lulezime Celami	celamilulezime@yahoo.com	0692843901	
Mirditë					1-Marie Brozi	mariebrozi@gmail.com;	0692294616	
					2-Flora Lazri	lazriflora@yahoo.com	0683074415	
Kurbin					1-Armanda Çoniku	armanda_al@hotmail.com;	0693156083	
					2. Fran Dodaj	frandoda69@yahoo.com	0682453111	
Shkodër	Ilir Kanini	Ilir.Kanini@arsimi.gov.al	0682417530		Frida Kopliku	koplikufrida@yahoo.com	0696520106	
M. Madhe					Faik Semaj	faik.semanaj@gmail.com	0673071299	
Pukë					Samidije Lamaj	samidijel@yahoo.it	0686778058	
Korçë	Tatjana Vucani	Tatjana.Vucani@arsimi.gov.al	0692100298	2232455	Nikolin Germenji	nikolingermenji@hotmail.com	0689078324	082242872
Kolonjë					Mehmet Cane	za_erseke@yahoo.com	0682585841	
Pogradec					Sotiraq Mangeri	sotiraq1mangeri@gmail.com	0692693649	
Devoll					Alma Hoxhalli	alto831@yahoo.com	0698452053	
Vlorë	Marjana Lako	Marjana.Lako@arsimi.gov.al	0672738231		Juljan Muhameti	Juljan.muhameti@gmail.com	0694414848	
Sarandë					Marsela Gurma	katinagogo@gmail.com	0695664401	
Delvinë					Jorgo Zhono	jorgozhonga@yahoo.com	0692955364	
Kukës	Besnik Rama	Besnik.Rama@arsimi.gov.al	0672665525	2232455	Melita Omuri	Melita.qkf@hotmail.com	0682196722	
Has					Jetmir Qaushe	Kurrikula.za.has@hotmail.com	0689080651	
Tropojë					Shaqir Murati	shaqirmurati@yahoo.com	0672075548	



BIBLIOGRAFIA

- Standardet e shkollës miqësore për fëmijët në Shqipëri: UNICEF, 2011
- Standardet për shkollat mike për fëmijë (Drafti I): Prishtinë, 2012
- Coalition for Community Schools: <http://www.communityschools.org>
- PTA National standards for family-school partnerships: an implementation guide, 2009, USA.
- Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës: rekomandime për një partneritet të suksesshëm shkollë-familje-komunitet: Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë, 2011.
- Community school transformation: A guide for schools, districts, parents and community members.
- Schools as centers of community: A citizens' guide for planning and design. Washington, D.C., 2000.
- Notre vision de l'école communautaire: Cadre de référence, Commission scolaire de Montreal, 2007
- National Framework for before and after school activities in basic education 2011: Finnish Board of education.
- National Center for Family and Community Connections with Schools: <http://www.sedl.org/connections>
- National Coalition for Parent Involvement in Education (NCPIE): <http://www.ncpie.org>
- Communities in Schools: <http://www.cisnet.org>
- Keeping Schools Open as Community Learning Centers: Extending Learning in a Safe, Drug-Free Environment Before and After School:
- <http://www.ed.gov/pubs/LearnCenters/>
- Safe and Smart: Making the After-School Hours Work for Kids
<http://www.ed.gov/pubs/SafeandSmart/index.html>
- Safe Passages by Joy Dryfoos. Oxford University Press, 1998.